



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor**

**“Gjuhë Italiane”**

**Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**



- 1. Prof. Asoc.Dr. Mirela Papa**
- 2. Prof. Asoc. Dr Aida Gjinali**

Qershor , 2021



**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bsc në “Gjuhë Italiane” të ofruar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja (Fakulteti i Shkencave Humane).
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë Italiane”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Ky program studimi është hapur me Shkresë të MASH Nr. 2234, datë 17.06.2002
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Me Vendim Senati Nr. 58, datë 06.09.2018 janë miratuar ndryshime në masën 20% për përshtatjen e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Miratuar edhe me shkresë MASR Nr. 10761/1, datë 25.10.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli 1
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Italisht (Shqip)
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE/0 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A 2017-2018, 14 Studentë V.A 2018-2019, 0 Studentë V.A 2019-2020, 0 Studentë
19	Komente / të tjera:	-



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës

Programi Bachelor në “Gjuhë Italiane” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të huaja, Fakulteti i Shkencave Humane të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Programi është miratuar për hapje me Aktin nr. 2234 datë 17.06.2002 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me emërtim diplome “Mësues i Gjuhës Italiane”, në sistemin 4-vjeçar me shkëputje nga puna. Programi është në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë që i formojnë ata si profesionistë dhe mësues të gjuhës italiane.

Kurrikula e programit është e ristrukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 180 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademike. Programi ofron kualifikim të nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit për të përvijuar studimet në programe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë, përkthimit dhe studimeve të specializuara gjuhësore.

Departamenti i Gjuhëve të huaja ofron gjithashtu edhe tre programe të tjera për ciklin e dytë të studimeve në MP në “Mësuesi për CLAB në lëndën gjuhën Angleze me drejtim minor gjuhë italiane” MP “Mësuesi për CLAB në lëndën gjuhën Italiane me drejtim minor gjuhë frengje” dhe MSH në “Përkthim dhe interpretim”.

Në programin Bachelor në Gjuhë Italiane, ka një rënie të regjistrimeve ndër vitet 2012-2017 me një mesatare rënie prej - 20%, ndërsa për vitet 2018- 2020 nuk ka asnjë regjistrim (Evidenca Studimi i Tregut në rang Universiteti).

Në programin Bachelor në Gjuhë Italiane, janë diplomuar 500 studentë në vitet akademike 2002 - 2019. (Evidenca III.12).

DGJH ka 24 personel akademik ku 23 janë me kohë të plotë 7 Prof. Asoc. Dr, 9 Dr., 1 në proces Dr, 8 MSC dhe një personel vizitor si dhe 3 punonjës ndihmës-akademikë (Aneksi 1).

Personeli akademik i angazhuar për realizimin e programit “ Bachelor ne Gjuhë italiane” ka të angazhuar për vitin akademik 2019- 2020, përkatësisht 9 PAE; 1 Prof. Dr, 2 Prof Asoc, 1 doktorant, 5 Msc, dhe 1 lektor i huaj doktorant (Aneksi Tab 5.3)

Departamenti bashkëpunon gjithashtu edhe me njësi të tjera, të këtij insitucioni, si Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe Departamentin e Shkencave Kompjuterike. Njësia ka nënshkruar edhe një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera në kuadër të mobiliteteve staf dhe studentë të këtij programi.

Programi i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të programit Bachelor në “Gjuhë italiane” filloi me hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm nga një grup prej shtatë anëtarësh prej të cilëve pesë personel akademik, një personel ndihmës-akademik dhe një student. Në lidhje me hartimin e raportit për vlerësimin e brendshëm u ngrit një grup pune i miratuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane i cili pas formimit të tij që këtej e tutje do të cilësohet si GVB.

Hartimi i këtij raporti nga GVB përfshin një dokumentacion prej 86 evidencash të paraqitur online në platformën e ASKAL, që mbështesin kuadrin ligjor, menaxhimin institucional dhe administrimin e këtij programi, në lidhje me rregulloret dhe planet strategjike të zhvillimit, stafin akademik dhe studentët, objektivat e programet dhe rezultatet e të nxëniet, aktorët mbështetës, sigurimin e cilësisë dhe administrimin financiar dhe infrastrukturor në dispozicion të tij.

GVJ kërkoi gjithashtu edhe 9 dokumente shtesë gjatë vizitës virtuale me qëllim plotësimin e kuadrit të përgjithshëm dhe specifik të RVJ.

Hartimi i RVB nga GVB tregon për një punë të zhvilluar me shumë kujdes dhe profesionalizëm në lidhje me analizën e përmbushjes së standardeve dhe koherencë në pasqyrimin konkret të dhënave në pjesët përshkrimore. Gjatë takimit me GVB u paraqit modaliteti i punës së zhvilluar vështirësitë apo problematikat e hasura dhe zgjidhjet për kapërcimin e tyre. GBV pasqyroj ne detaje punën e zhvilluar edhe gjatë takimit (Tak 2) dhe saktësoi informacione të nevojshme për GVJ në lidhje me realizimin e hartimit të këtij raporti.

ASCAL bazuar në kërkesën e UV për akreditimin e këtij programi, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për:


- Shqyrtimin e dokumentacionit e përcjellë nga institucioni,
- Kryerjen e vizitës në institucion dhe
- Hartimin e RVJ

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) përbëhet nga:

1. Prof.Asoc.Dr Mirela Papa
2. Prof. Asoc.Dr. Aida Gjinali

Fillimisht GVJ u trajnua në lidhje me procedurën e vlerësimit të jashtëm, me funksionimin e sistemit online te ASKAL, me dokumentacionin ekzistues dhe me modelin e hartimit të raportit. GVJ e zhvilloi këtë trajnim online i cili shërbeu për t'u njohur më në detaje me procesin e hartimit të raportit. Gjatë gjithë fazës së shqyrtimit të materialeve, takimeve online dhe hartimit të raportit përfundimtar GVJ u asistua vazhdimisht nga koordinator teknik i ASKAL përfaqësuar nga Znj. Arjana Alija.

Në lidhje me vizitat në terren në institucion ato u kryen online (shkak pandemia Coronavirus) në dy ditë, dt. 1-2 prill 2021. Gjatë këtyre vizitave GVJ organizoi takime me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, grupin e vlerësimit të brendshëm, përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Istitucional (NJBSCI), stafin akademik





dhe studentët, përfaqësues të sekretarisë mësimore, përfaqësues të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore dhe përfaqësues të Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I & II. GVJ kreu gjithashtu vizitën virtuale të ambienteve në dispozicion të mësimdhënies dhe të nxënit në këtë program studimi, sekretarinë mësimore, Laboratorin e Gjuhëve të huaja, Laboratorin e Informatikë-Fonetikës, Sallën e Smartbordit, Zyrën e Këshillit Studentor, si dhe Bibliotekën Qendrore, Bibliotekën e Fakultetit dhe atë të Departamentit, Këndin e leximit. Takimet me grupet e përmndura më lart, shërbyen për të qartësuar GVJ në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij dhe bazuar në të gjitha sa më sipër GVJ hartoi RVJ – në si në vijim.

.....  
Më datë 01.06.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare 1/57 prot, datë 01.06.2021 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 08.06.2021 dhe me shkresë zyrtare Nr. 973/1 Prot, datë 07.06.2021.

**GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit Bachelor Gjuhë Italiane pasi u njoh me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (DRVJ), dërguar *elektronikisht në datë 01.06.2021*, nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë të UV-së, shqyrtoi dhe vlerësoi përmbajtjen e DRVJ-së për programin e studimit Bachelor Gjuhë Italiane.

Pas leximit të draft-raportit, GVB bën këto vëzhgime në formën e komenteve apo saktësimeve:

1. Tek “Përshkrim përmbledhës” thuhet “Departamenti i Gjuhëve të huaja ofron gjithashtu edhe tre programe të tjera Bachelor në “Gjuhë italiane”, MP në “Mësuesi për CLAB në lëndën gjuhë angleze” dhe Msc në “Përkthim dhe interpretim”.”.

**Saktësim: në raport është thënë që DGJH ofron gjithashtu edhe 3 programe të tjera për ciklin e dytë duke iu referuar faktit që programet bachelor janë apriori ekzistues dhe njëri prej tyre është objekt i shqyrtimit. (por sigurisht që mund të paraqiten dhe ato Bachelor dhe bëhen gjithsej 5 programe në total që i ofron DGJH dhe jo 4 si më poshtë shënuar) (evid I.25, fq. 4)**

Saktësojmë që “Departamenti i Gjuhëve të huaja ofron gjithashtu edhe katër programe të tjera: Bachelor në “Gjuhë italiane”, MP në “Mësuesi për CLAB në lëndën gjuhë angleze”, MP në “Mësuesi për CLAB në lëndën gjuhë italiane” dhe Msc në “Përkthim dhe interpretim”.”

2. Tek fusha 2,

- standardi II.4, kriteri 4 jepet ky sugjerim nga GVJ-ja:

“Këshillohet kalimi i disa lëndëve në Master si:  
- Metodologji e mësimdhënies (kërkon formim bazik paraprak të studentit dhe është lëndë profilizuese) Është lëndë bazë për formimin e mësuesit.  
-Lënda Metodat e Mësimdhënies është një lëndë specifike që për natyrën që ka i drejtohet mësuesit të gjuhës së huaj dhe gjithashtu kërkon një formim paraprak të studentit me nocione bazë të cilat lidhen me Didaktikën e gjuhëve të huaja (brenda syllabusit ka nocione të Didaktikës të nevojshme



për formimin bazë dhe i referohet shumë pak metodave ndaj rekomandohet ndryshimi i emërimit të lëndës dhe dhënia e njohurive bazë që mundësojnë formimin për ciklin e dytë të studimeve që është i profilizuar dhe profesional për mësuesinë).

-Lënda TIK është një lëndë specifike profilizuese-profesionale për mësuesin e gjuhës ndaj me një profilizim të karakterit të saj ajo rekomandohet të kalohet në ciklin e dytë dhe kategorizimi i saj është A/B, ndaj nuk mund të jetë një lëndë me zgjedhje (syllabusi brenda tij paraqet shumë pak nocione që lidhen me përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në funksion të mësuesit dhe mësimdhënies, Rekomandohet rishikimi i emërimit dhe konceptimi i lëndës TIK në Master.

Komenti ynë:

1. Sa i takon lëndës *Metoda të Mësimdhënies (ITA 341)*, kjo është një çështje që është trajtuar mjaft në departament. U konsiderua fillimisht që kjo lëndë të hiqej nga ky program pasi u argumentua gjerë kalimi i saj në programin MP (me të njëjtën logjikë u gjykua edhe për lëndën e përkthimit), por në fund u konkludua që lënda të ruhej siç është nga pikëpamja formale (numër kreditesh, orësh, lëndë e detyruar), ashtu si edhe lënda e përkthim-interpretimit, por nga pikëpamja përmbajtësore, të mjaftohej me një hyrje në metoda në mësimdhënien e gjuhës së huaj, ndryshe nga sa ishte ofruar dikur.

**Saktësim: Nuk është sugjeruar heqja e lëndës por kalimi i saj në Master si lëndë me emërtimin Metodologji e mësimdhënies dhe riemërtimi e riorganizimi i syllabusit ekzistues në Bachelor me arsyetimin e mposhtëm të sjellë edhe në raport:**

Lënda *Metodat e Mësimdhënies* është një lëndë specifike që për natyrën që ka i drejtohet mësuesit të gjuhës së huaj dhe gjithashtu kërkon një formim paraprak të studentit me nocione bazë të cilat lidhen me Didaktikën e gjuhëve të huaja (brenda syllabusit ka nocione të Didaktikës të nevojshme për formimin bazë dhe i referohet shumë pak metodave ndaj rekomandohet ndryshimi i emërimit të lëndës dhe dhënia e njohurive bazë që mundësojnë formimin për ciklin e dytë të studimeve që është i profilizuar dhe profesional për mësuesinë.

Arsyet për këtë lidhen me disa argumente të natyrës teknike dhe përmbajtësore në program:

- Kurrikulat menaxhohen përmes UVMS (sistemi menaxhues) dhe aspekte të ndryshimeve në program shumë herë duhen parë edhe në këtë kuptim (teknik), pra të mos sjellim komplikime (p.sh. kur vjen puna për procedura njësimi), sigurisht pa çenuar vetë forminin dhe programin e studimit.

**Saktësim: Pikërisht për të mos krijuar këtë lloj anomalie dhe për të shmangur këtë lloj komplikimi që do të lindte padyshim për shkak të emërimit të lëndës ndaj dhe është përcjellë sygjërimi i mësipërm.**

- Shumë studentë angazhohen part-time në mësimdhënie në qendrat e gjuhëve të huaja qysh në nivelin "Bachelor", kështu që i kanë të nevojshme disa koncepte bazë në këtë drejtim.

**Saktësim: Arsyetim i argumentuar më lart për të cilin biem dakort fare qartë të dyja palët.**



- Krahasimi me programet ku realizohen shkëmbimet studentore ka dëshmuar që një lëndë e tillë është pothuaj gjithmonë e pranishme në programe të tilla studimi. Kjo lehtëson edhe proceset e përzgjedhjes dhe njohjes së lëndëve që studenti do të marrë.

**Saktësim: Në programet Bachelor bëhet fjalë për njohuri bazë dhe ato janë të konceptuara si nocione Didaktike apo Glotodidaktike. Metodologjia e mësimdhënies siç është sqaruar dhe në RVJ është specifike e formimit të thelluar profesional të mësuesit.**

2. Lënda TIK në mësimdhënie nuk ekziston në programin Bachelor. Saktësojme që ajo ofrohet si lëndë në programin “MP në mësuesi për CLAB në gjuhë italiane” me kodin ITA 462 (TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj).

Në programin Bachelor ofrohet vetem lënda Shkenca kompjuterike (kodi CS 100).

**Saktësim: Ne nuk jemi në dijeni të ekzistencës së saj në Ciklin e dytë pasi nuk ka qenë objekt i punës tonë. Ajo që është saktësuar është fakti tjetër i paraqitur në RVJ që:**

“Kjo lëndë në fakt del me dy emërtime të ndryshme. Në planin mësimor del me emërtimin Shkenca kompjuterike ndërsa brenda në syllabus paraqitet si TIK (Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit) dhe përmbajtja është informatikë kompjuterike. Rekomandohet rishikimi i emërtimeve dhe konceptimi i lëndës TIK në Master.” ( Evid II.2 fq 13).

3. Lënda e Gjuhësi e Aplikuar ekziston në kurrikul si lëndë me zgjedhje. Duke e konsideruar si më me dobi për formimin e mësuesve të ardhshëm, ka kaluar si lëndë e detyruar në programin “MP në mësuesi”. (ITA 461 – Gjuhësi e Aplikuar)

**Saktësim: Ne nuk ishim në dijeni të këtij kalimi, por gjithsesi qëndron fakti që duhet të konceptohet një lëndë tjetër me zgjedhje, pasi nuk mund të ketë dy lëndë me të njëjtin emërtim si në ciklin e parë ashtu edhe në të dytin, pavarësisht faktit që njëri është me zgjedhje apo i detyruar, apo që janë të ndryshme në brendi të tyre.**

4. RVJ komenton:

“Syllabusi ITA 170 nuk i përmbahet formatit të përcaktuar nga kuadri ligjor. Kodi është ekzistues por titulli i lëndës mungon. Përmbajtja në tematika për 45 orë lex/45 sem lë për të dëshiruar. Ka një numër shumë të madh orësh të pajustificuara për një lëndë të kësaj natyre që duhet të jetë shumë praktike dhe me tema mjaft të larmishme motivuese e nxitëse me qëllim zhvillimin e aftësisë së shkrimit. Ajo paraqet gjithashtu një numër shumë të madh kreditesh 8 ETC, pavarësisht që është e ndarë në dy module. Gjithashtu moduli i dytë i kësaj lënde Shkrimi Akademik as që mund të konceptohet për studentë të vitit të parë ndaj kjo lëndë duhet riparë dhe riprogramuar krejtësisht.”

Sqarimi ynë:

Pas përfundimit të procesit të akreditimit, sigurisht që do të ketë një analizë të thelluar të silabuseve dhe shpërndarjes së raportit teori-praktikë. Në këtë kontekst, pedagogia e lëndës konfirmon se do të ketë një rikonceptim të moduleve në përputhje me sugjerimet dhe komentet e bëra nga GVJ, por jo vetëm edhe për t’ju ardhur sa më pranë kërkesave e nevojave të studentëve.




5. Saktësojmë që te fusha II, duhet të bëhet “plotësisht” pasi janë përmbushur 4 kritere “plotësisht” dhe 1 “kryesisht”.

**Saktësim: Fusha II pavarësisht faktit që ka të përmbushur kriteret e tjerë është pikërisht fusha ku kriteri “kryesisht” përbën dhe një nga kriteret më të rëndësishëm në lidhje me organizmin, përmbajtjen dhe cilësinë e programit të studimit dhe syllabuseve përbërës të tij, ku dhe u hasën problematikat për të cilat janë ofruar sygjerimet përkatëse. Dhe është pikërisht programi ai që dhe merr peshën më të madhe në këtë akreditim, ndaj në lidhje me këtë fushë ne i mbetemi mendimit që vlerësimi të qëndrojë i pandryshuar.**

6. Lidhur me sugjerimin e RVJ-së për uljen e kriterit të notës mesatare për punimin e diplomës, në programin Bachelor: “Në lidhje me punimin e diplomës, studenti duhet të përmbushë kriterin e notës mesatare 9 (Vendimi i SA 09/2017), paraqet një projekt propozim sipas standarteve (Vendim SA n.65/2016) që i gjen të publikuara online në faqen e UV. Rekomandohet: Ulje e mesatares së kërkuar për punim diplome, për të mos penalizuar ata studentë që edhe pse me mesatare më të ulët se 9 janë të aftë të hartojnë një të tillë. Mesatarja jo gjithmonë reflekton realitetin formues dhe aftësitë kërkimore. Rekomandohet mesatarja mbi 7”
7. Saktësojmë që meqënëse ky kriter është i miratuar me vendim senati, çdo ndryshim nga ky kriter do të kërkojë vendimmarrje nga ky organ kolegjal.

**Saktësim: Ne menduam që do ishte me vend mospërrjashtimi i një numri të madh studentësh nga një mundësi kërkimore autonome që do t'i jepte atyre mundësinë të vinin në provë sfiduese pozitive, aftësitë e marra. Gjithashtu praktikat evropiane nuk e marrin në konsideratë faktin e mesatares madje është detyrim përmbyllës hartimi i një teme diplome, ndaj dhe u sugjerua, por nëse kjo është kaq e pamundshme mund të anashkalohet. (Mundësia e realizmit ndoshta mund të bëhej me një kërkesë të arsyetuar e cila sigurisht mund të kalohet sërish në senat).**





# Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Gjuhë italiane”

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor “Gjuhë italiane” ofrohet në përputhje me përcaktimet e Statutit (Evidenca A, neni 3, pika 2 shkronja b) dhe të Planit Strategjik të Universitetit “Ismail Qemali” (UV) (Evidenca B, Vizioni fq 22-23, Misioni fq 24) si dhe me misionin e Fakultetit të Shkencave Humane (FSHH) (Evidenca I.1) dhe atë Departamentit të Gjuhëve të huaja (DGJH), si njësi përbërëse të tij (Evidenca I.2). Programi nuk bie ndesh me interesat kombëtare duke qenë se ai synon kualifikimin e specialistëve në mësimdhënie, përkthim, interpretim, dhe shkenca gjuhësore dhe komunikim.(Evidenca I.4, neni 2). Programi mundëson njohuri bazë që i mundësojnë studentëve të vijojnë ciklet e mëtejme të studimit me drejtime të ndryshme profesionale si: mësues, përkthyes, kritik letrar, etj. Programi me ofertën e tij akademike plotëson profilin kulturor kombëtar.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Vetë DGJH synon ruajtjen e vazhdueshme të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, të detajuara këto në kornizën ligjore që rregullon veprimtarinë e tij (Evidenca I.2/I.5). Ai synon që me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të aftësojë studentët të përdorin me efikasitet gjuhën e huaj dhe të përvijojnë studime të thelluara të ciklit të dytë në fushat e përkthimit, interpretimit, mësimdhënies dhe komunikimit për të zhvilluar koncepte shkencore të studimit gjuhësor dhe letrar, në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore që mbart një institucion i arsimit të lartë në Shqipëri. (Evid I.4, neni 2, 3)
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UV (Evidenca A, neni 3) dhe është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (Evidenca I.3; I.13). Ai është hartuar në përputhje me objektivat e DGJH (Evidenca I.4 neni 2 me anë të të cilave si synon të formojë specialistëve me: <ul style="list-style-type: none"><li>- Një formim gjuhësor dhe shkencor me drejtim human, me qëllim që ata të jenë në gjendje të ndjekin kurse të përparuar studimi apo të marrin një drejtim në ato fusha ku aftësia për të përdorur një gjuhë të huaj me efikasitet dhe ndjeshmëri është thelbësore</li><li>- Sigurinë dhe aftësinë për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara sidomos në fushën e përkthimit, interpretimit dhe mësimdhënies, komunikimit për të zhvilluar koncepte shkencore të studimit gjuhësor e letrar;</li><li>- Baza për të studimin e thelluar në ciklin e dytë të studimeve në drejtim të ndryshme profesionale si: mësues përkthyes, kritik letrar etj</li></ul> DGJH bazuar në planin strategjik të saj (Evidenca I.5) synon kualifikimin e stafit mësimdhënës, diversifikimin e aktiviteti shkencor, mësimdhënie bashkëkohore, sigurimin e cilësisë, ndërkombëtarizimin e programeve, angazhimin e studentëve dhe partneritetin. DGJH e ka orientuar veprimtarinë e tij drejt kombëtarizimit dhe synon të



	<p>nxisë bashkëpunime në projekte kërkimore dhe zhvillimore ndërkombëtare, të nxisë vizibilitetin e punë kërkimore shkencore si dhe shkëmbimin e stafit dhe të studenteve me anë të programeve të ndryshme ndërkombëtare si Erasmus +, etj.</p> <p>DGJH gjithashtu synon të bëhet pjesë e zhvillimeve inovatore në studimet gjuhësore, letrare dhe kulturore dhe të rrisë cilësinë dhe performancën e saj në mësimdhënie e më tej duke ngritur dhe grupet mësimore brenda njësisë duke mundësuar kështu një kontroll më të mirë të kësaj cilësie dhe performance jo vetëm të stafit por edhe të vetë programeve të studimit dhe të kërkimit shkencor (Evidenca I.18).</p> <p>Gjithashtu DGJH synon edhe nxitjen e modernizimit dhe riorganizmin e vazhdueshëm dhe harmonizimin e kurrikulave me ato të programeve të departamenteve simotra në IAL-të e tjera si brenda ashtu edhe jashtë vendit (Evidenca I.4; Evidenca I.22).</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi Bachelor “Gjuhë italiane” ofrohet në përputhje me përcaktimet e Statutit të UV-së (Evidenca A, neni 3, pika 2 gërma d), duke synuar zhvillimin social dhe kulturor të rajonit dhe më gjerë, në referencë të objektivave formues të lartpërmendura të vetë programit dhe të vizionit afatgjatë të UV qëllimit dhe misionit të tij (Evidenca A, neni 3, 4)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Në statutin e UV-s, përcaktohet qartë që programet e studimit ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e vetë institucionit dhe kjo është e shprehur qartë në objektivat si ato afatmesme dhe afatgjatë (Evidenca B, fq 37-39) të hartimit të programeve të studimit me anë të të cilave ai synon që, duke gërshtuar mësimdhënien me kërkimin shkencor, të përgatisë jo vetëm specialistë në fushat përkatëse të studimit, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. (Evidenca A, neni 3 pika 2 shkronja b)</p> <p>Programi synon përgatitjen e specialistëve të gjuhës së huaj e ofrohet në përputhje me pikësynimet strategjike të UV-s të përcaktuara në Planin Strategjik 2018-2024 të këtij të fundit (Evidenca B, Kap.V).</p> <p>Ai gjithashtu përputhet me Planin strategjik të DGJH, i cili synon angazhimin e njësisë në zhvillimet novatore të studimeve gjuhësore, letrare dhe kulturore dhe risitë pedagogjike që lidhen me mësimdhënien në këto fusha. (Evidenca I.5)</p> <p>Përputhja me Planin strategjik dhe Misionin e UV dhe Planin strategjik të DGJH dhe Vizionin e saj, synon bërjen e kësaj njësie “pararojë në nivel institucional dhe kombëtar në kërkimin në shkencat humane, në mësimdhënie, shërbim ndaj komunitetit” si dhe synon të arrijë një formim të tillë të studentët që t’i bëjë ata të aftë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese, të thelluar dhe shkencore për gjuhën, kulturën, letërsinë, shoqërinë dhe teknologjinë” (Evidenca I.5)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet	Përcaktimet në rang institucional të Statutit UV (A, neni 4) dhe Rregullores UV (Evidenca C, neni 4) në lidhje me drejtimit prioritar akademike detajohen në Rregulloren e FSHH si “përmbajtje thelbësore në shkencat humane” (Evidenca I.6, neni 3/1,2,3) dhe në Rregulloren e



e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	brendshme të DGJH e cila përcakton si mision të këtij të fundit "Përgatitjen e specialistëve të gjuhës të aftë për të shërbyer në sektorin publik dhe privat në mësimdhënie, përkthim dhe interpretim dhe të shkencëtarëve të rinj për të vazhduar studime të thelluara në fushat gjuhësore, kulturore dhe letrare në përgjigje të tregut të punës në Shqipëri dhe vende të tjera."(Evidenca I.2, neni 2)			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë hartuar në përputhje me përcaktimet e bazës ligjore të sipërpërmendur. Ato janë në përputhje me fushat akademike të institucionit, fakultetit dhe departamentit që i ofron. Ai funksionon sipas strukturës së përcaktuar në Statutin e UV (Evidenca A neni 3, pika 2, shkronjat a,b,c, dhe nenet 57, 58), Rregulloren e UV (Evidenca C, nenet 4, 36, 37), të miratuar nga Senati Akademik i UV, Rregulloren e FSHH (Evidenca I. 6, neni 43 pika 1, neni 5) dhe Rregulloren e vetë DGJH (Evidenca I. 2 neni 2 pika 2, neni 15). Ristrukturimi i programit me qëllim përditësimin e kornizës ligjore kombëtare bëhet në përputhje me këtë të fundit. (Evidenca I.7)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Në lidhje me objektivat formuese Rregullorja e programit përcakton si objektiva formuese të programit, përgatitjen e specialistëve me formin gjuhësor (teorik dhe praktik) dhe shkencor (me drejtim human) në fusha si, përkthim, interpretim, komunikim dhe mësimdhënie. Programi synon gjithashtu hedhjen e bazave për thellimin e studimeve në këto fusha në ciklin e dytë. (Evidenca I.4, neni 2, gërmat a,b,c). Rregullorja përcakton shprehimisht aftësitë dhe kompetencat bazë dhe profesionale që fiton studenti në këtë program, por kjo përcaktohet në pjesët përshkrimore të lëndëve/moduleve që ndjekin planin mësimor të Rregullores së programit (Evidenca II.2).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	DGJH ka paraqitur një studim të tregut të punës në kuadër të akreditimit të programit. Ky studim përfshin analizën e tregut të punës lidhur me punësimet për të diplomuarit e viteve 2003-2018 bazuar në profilin e diplomës që përfshijnë: mësimdhënien, përkthimin, guidën turistike, administratën publike dhe sektorin privat. Për realizimin e këtij studimi tregu pune DGJH ka shfrytëzuar të dhëna statistikore të marra nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e punës</li> <li>- Faqet zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ambasadës Italiane për përkthyesit ligjorë</li> <li>- Sektori i Studentit, zyra e Alumnit pranë Rektoratit të UV</li> <li>- Sekretaria Mësimore pranë DGJH të UV.</li> </ul> <i>Evidentohet</i> <i>Studimi pasqyron një analizë përgjithësisht të plotë (për shkak vështirësive dhe mangësive të përmendura nga GVB, Evidenca I.10), vihet re një mungesë statistikore ezauruese e cila do të mundësonte një analizë reale të gjendjes së tregut.</i> <i>Megjithë faktin që në raport thuhet që Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Aktivitete Kulturore Sportive kryejnë periodikisht mbledhje</i>



	<p><i>të dhënash dhe gjurmon ecurinë e tyre, (Evidenca I fq 117-139), reflektimi i këtyre të dhënave është përgjithësues.</i></p> <p><i>Gjithsesi bazuar mbi këtë analiza tregu pavarësisht mangësive apo problematikave që ai ka hasur gjatë realizimit të tij stafi akademik (pjesë e grupit të punës) dëshmoi vijueshmërinë e punës në kurrikul mbi bazën e kësaj analize. (Tak.3)</i></p> <p><i>Studimi gjithashtu pavarësisht faktit që paraqet fushat kryesore të punësimit sipas programi të studentëve, nuk ka një informacion të detajuar në lidhje me faktin nëse studentët e diplomuar në këtë degë janë të punësuar në profile të ndryshme nga ai i diplomës. Paraqitja e një përqindje prej 50% në profil nuk mund të japë të dhëna të sakta në lidhje me realitetin ekzistues.</i></p> <p><i>Gjithsesi DGJH e ka bazuar punën e saj në varësi të këtyre analizave kryesore të zhvillimit të ardhshëm të programit në përputhje me prirjet e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. (Evidenca I.22)</i></p> <p><i>DGJH është bërë gjithashtu pjesë e aktiviteteve institucionale që lidhin studentët me tregun e punës (Evidenca I.11/I.12/Tak.1), megjithatë nuk reflekton ndërmarrje individuale të vetë njësisë për specifikat e vetë programit. Analiza vjetore e DGJH përfshin gjurmimin e të dhënave në lidhje me vëmëndjen që i kushtohet studentëve pas diplomimit dhe mbajtjen e lidhjeve me alumni por mekanizmat dhe mjetet e përdorura për këtë qëllim nuk mund të jenë aq efikase sa të ofrojnë e pasqyrojnë në masë të madhe realitetin ekzistues. (Evidenca I.22)</i></p> <p><i>Madje vetë analiza e studimit të tregut të punës reflekton një numër më të vogël studentësh të gjurmuar, në krahasim me numrin real të studentëve të diplomuar.</i></p> <p><i>Gjithsesi këto analiza mundësojnë nxjerrjen e konkluzioneve dhe sugjerimeve për të orientuar programin e studimit drejt një përmiresimi dhe rinovimi të tij si dhe për hartimin e strategjive të reja për me qëllim përthithjen e studentëve dhe formimin e tyre të orientuar drejt këtij tregu.</i></p> <p><i>GVJ duke iu referuar studimit të tregut por dhe gjurmimit të studentëve sugjeron që DGJH duhet të rrisë gamën e ruajtjes së lidhjeve me alumni dhe të gjenerojë forma të tjera të përfshirjes së tyre konkrete në aktivitetin e tij akademik dhe kërkimor. Gjithashtu sugjeron përdorimin e formave të tjera të gjurmimeve dhe një bashkëpunim më të ngushtë me institucionet vendore, komunitetin e biznesit lokal etj., me qëllim që nga analizimi i saktë i realitetit të tregut të punës të drejtojë, përmirësojë programet aktuale dhe të hartojë programe të reja apo të përditësuara që mundësojnë përthithjen e një numri më të madh studentësh për të cilët ky program po vuan tashmë prej dy vitesh.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>DGJH reflekton një prirje pozitive ndaj marrjes parasysh të interesave të tregut të punës dhe kompetencave bazë të të diplomuarve. (Evidenca I.8).</p> <p>Plani strategjik i zhvillimit të DGJH parashikon rivlerësimin e dijeve të ofruara me qëllim përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës (Evidenca I.5, Evidenca I.9) dhe shkëmbimin e konsiderueshëm të përvojave falë mobiliteteve staf/studentë me universitete partnere.</p> <p>Për këtë qëllim konstatohet që pas analizave të kryera brenda njësisë bazë në grupet e ngritura mësimore brenda këtij departamenti, janë realizuar gjithashtu ndryshime në lidhje me programet e ekzistuese. (Evidenca I.13)</p> <p>Objektivat lëndore synojnë përfitim e dijeve që i aftësojnë studentët në fushat kryesore të studimit për studime të mëtejshme në ciklin e dytë: gjuhësi, përkthim, mësuesi, kulturë dhe letërsi. (Evidenca I.4)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	



**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>UV u krijuar më 1994 (V.K.M. 105/1994). Në përshtatje me kërkesat e kohës e zhvillimeve dinamike rajonale UV e pa të arsyeshme hapjen e profileve të reja shkencore shoqërore duke themeluar edhe FE ku u integrua DGJH. Fe më pas u riemërtua si FSHH më 2009 pas atashimit të FD pranë tij. (Evidenca I. 15)</p> <p>FSHH përbëhet nga 4 njësi bazë dhe një qendër kërkimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- DGJH</li> <li>- Departamenti i Drejtësië</li> <li>- Departamenti i Edukimit</li> <li>- Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë</li> <li>- Qendra e Kërkimit Shkencor e Albanologjisë dhe Ballkanistikës</li> </ul> <p>Qendra e kërkimit shkencor e Albanologjisë dhe Ballkanistikës të cilat ndërveprojnë ngushtë me njëra-tjetrën.</p> <p>DGJH ka aktualisht 24 pedagogë me kohë të plotë për vitin 2019-2020, nga të cilët 6 Profesorë të asociuar, 10 Doktorë të shkencave, 2 Dr. proces dhe 6 Master të shkencave. (Aneksi , Tab.1.1)</p> <p>Në programin Bachelor në “Gjuhë italiane” janë të angazhuar 9 PAE për vitin 2019- 2020, 1 Prof.Dr, 1 Prof. Asoc. 1 Dr, 1 doktorantë dhe 4 Msc. (Evidenca III.12) dhe 1 lektor i huaj italian MAE doktorant. (Aneksi tab 6.1)</p> <p>Kualifikimi i stafit përkon me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë dhe me profilin e lëndëve që mbulojnë. (Evidenca II.12)</p> <p>Për sa më sipër DGJH demonstroi se ka kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi.</p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi ofron kualifikim të nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Ligji nr. 10 247/2010) dhe ka për qëllim përgatitjen e specialistëve të gjuhës italiane (Evidenca I.4 neni 2, Evidenca I.8). Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi qëndron brenda kornizës së fushës akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (Evidenca I.3/I.6, neni 3).</p> <p>RVB përcakton gjithashtu përputhjen e programit me fushën e gjerë, kodi 020 “Artet dhe Shkencat humane” dhe fushën e ngushtë, kodi 020 “Shkencat humane pa përcaktime të mëtejshme” të klasifikimit Standard Ndërkombëtar për Arsimit (2013). (Evidenca I, fq 15)</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit përkojnë gjithashtu me fushën akademike dhe kërkimore të DGJH, i cili ofron kualifikimet e mëposhtme sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar për Arsimin: “Gjuhë” (kodi 023), “Gjuhë pa përcaktime të mëtejshme” (kodi 0231), përvetësimi i gjuhës” (kodi 0232), “letërsi dhe gjuhësi” (kodi 0239). Këto të fundit pasqyrohen në objektivat e përgjithshëm formues dhe në strukturën lëndore të programit.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 1861 794 1921">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="794 1861 1018 1921">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1018 1861 1241 1921">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1241 1861 1436 1921">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al



**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësi ve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit mban përgjegjësi njësi propozuese, pra DGJH, bazuar kjo në ligjin 80/2015 (neni 1,3,7,8,) të Statutit UV (Evidenca A neni 10, pikat 6,7,8) Rregullores UV (Evidenca C, neni 37).</p> <p>Stafi akademik në aktivitetin e tij asistohet nga sekretari dhe laboranti për çështje administrative, teknike dhe teknologjike (Evidenca I.2, neni 13,14) Studentët asisitohen nga sekretaria mësimore (Evidenca I. 2, neni 12)</p> <p>Brenda DGJH funksionojnë 4 Grupet mësimore me karakter kërkimor (Ref. Stand. 1.4, Kriteri 1), të cilat bashkërendojnë mësimdhënien dhe kërkimin në grup-disiplinat përkatëse në program: gjuhësi, letërsi dhe kulturë, përkthim dhe gjuhë e huaj për qëllime të posaçme dhe metodikë. (Evidenca I.2 organigrama DGJH)</p> <p>Detyrat e personelit akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë në mbarëvajtjen e këtij programi përcaktohen në Rregulloren e DGJH (Evidenca I.2, kreu II,III), të hartuar në përputhje me Rregulloren e FSHH (Evidenca I.6, Kreu II), Statutin e UV-së (Evidenca A, Kreu II, III, IV, V) dhe Rregulloren e UV-s (Evidenca C, Kreu II, III, IV).</p> <p>Ndarjet specifike të punës dhe miratimi i strukturës organizative në funksion të programit, bëhen gjithashtu sistematikisht bazuar në aktet e brendshme të insitucionit (Evidenca I.) dhe, si të tilla u reflektuan edhe gjatë intervistës me GVJ (Tak. 5,6,7)</p> <p>Për realizimin e programit, DGJH-ja bashkërendon punën me njësitë e tjera brenda institucionit: Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike (FSHH), (Evidenca I.8).</p> <p>Detyrat e përgjegjës të departamentit, të përgjegjësve të grupeve mësimore, stafit administrativ dhe të koordinorit për studentët, përcaktohen në Rregulloren e DGJH. (Evidenca I.2, neni 4)</p> <p>Për realizimin e programit DGJH bashkërendon punën me njësitë e tjera brenda institucionit: Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike (FSHH), (Evidenca I.8).</p> <p>Departamenti kryen rregullisht vlerësim të performancës së stafit akademik (kryesisht atij të punësuar kohët e fundit bazuar në vendimet Senatit Akademik të universitetit (Evidenca I.20, Evidenca I.21).</p> <p>Ndarja e detyrave mes njësisë dhe personelit, marrjes së përgjegjësi ve dhe analiza e vazhdueshme e punës paraqitet në raportet periodike dhe analizat vjetore që kryhen nga njësitë dhe institucioni në lidhje me veprimtaritë kërkimore dhe atë financiare (Evidenca I.19). Kjo u konstatua nga GVJ edhe në takimin (Tak. N.3 dita 2).</p> <p>Programi i studimeve gjithashtu i nënshtrohen këtyre vlerësimeve periodike dhe analizave vjetore në nivel institucioni (Evidenca I) dhe në nivel njësie (Evidenca I.22)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi</p>	<p>Për realizimin e objektivave formues të procesit mësimor, UV vendos marrëdhënie bashkëpunimi, të reflektuara në marrëveshje bashkëpunimi (Evidenca I.23- I.24), me institucione homologe brenda vendit kryesisht për kryerje veprimtarish mësimore dhe kërkimore të përbashkëta me</p>






<p>me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>institucionet e tjera kryesisht për kryerjen e praktikave mësimore. Kwshtu kemi marrvveshje institucionale me isntitucionet lokale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Me Bashkinw e Vlorws</li> <li>- Dhe DAR Vlorw ( Evidenca I. 23)</li> </ul> <p>Gjithashtu këto marrëveshje bashkëpunimi shtrihen edhe jashtë vendit dhe kanë si qëllim pikësynim ndërkombëtarizimin (Evidenca D), UV është angazhuar kështu në bashkëpunime të frytshme me shumë universitete të rajonit, evropiane e amerikane, etj.</p> <p>Bashkëpunime të ndryshme tashmë prej 25 vitesh kryhen me universitete si: Universiteti i Leçes, Barit, Mesinës, Peruxhës, Kozencës, Liezhit (Finalndë), Valencës (Spanjë), Sofje (Bullgari), Universitetin e Beogradit (Serbi) etj.</p> <p>Kwshtu rendisim disa prej tyre:  “Marrëveshje mirëkuptimi”,  <a href="https://univlorra.edu.al/sektori-projekteve/mou-jashte-shqiperise/">https://univlorra.edu.al/sektori-projekteve/mou-jashte-shqiperise/</a> (RVB)  Marrëveshje me Universitetin e Beogradit (Evidenca I.24),  Marrëveshtje ndërinstitucionale në kuadrin e Erasmus + (Evidenca I.16)</p> <p>Gjithashtu UV është anëtar i disa rrjeteve ndërkombëtare për arsimin e lartë pjesëmarrjen në rrjete ndërkombëtare të arsimit të lartë si EUCEN, ASECU, CMU, pjesëmarrjen në projekte Erasmus, Horison 2020, INTEREG IPA, Iternational Credit Mobility (Evidenca I.16/ Evidenca V.1)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimave nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia raporton mbi efikasitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadër të mobiliteteve staf/studentë dhe organizimit të veprimtarive me karakter shkencor në raportin e Analizës vjetore në department (Evidenca I.22). Aty përcakohen edhe rekomandimet për përmirësim dhe detyrat për të ardhmen në këto drejtime. Kjo u konfirmua edhe në takime. (Tak.1).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Programi Bachelor në “Gjuhë italiane” nuk përfshin kredite të praktikës mësimore, për shkak të natyrës së tij.</p> <p>Praktika mësimore është pjesë e programit vijues të ciklit të dytë që ofron DGJH MP në “Mësuesi CLAB në lëndën e gjuhës italiane me drejtim minor gjuhë frënge” dhe MSH në “Përkthim-interpretim”.</p> <p>Për zhvillimin e praktikës ka një program të posaçëm që ndiqet nga pedagogu mbikqyrës i programit. Dokumentacioni i praktikës përmban marrëveshjen mes istitucioneve, listën e studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Trajnime profesionale të mëtejshme ofrohen për studentët e diplomuar pas ciklit të dytë. Kjo mundësohet nëpërmjet Qendrës së Zhvillimit Rajonal, e cila ofron module të të nxëniet gjatë gjithë jetës (Evidenca 1.27). Studentët janë githashtu pjesë e trajnimeve të organizuara në rang insitucioni në lidhje me projektet Erasmus + KA, CBHE, Re@WBC (Tak.5, dita 2).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--





## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. (Ligji 80/2015; neni 71, Pika 1)</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë italiane” është i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi (Ligji 80/2015 dhe VKM nr.41, dt.24.01.2018).</p> <p>Ai është i organizuar në tre vite akademike me 60 kredite secili. Në përfundim të studimeve, studenti fiton 180 ECTS dhe i ofrohet diploma Bachelor në “Gjuhë italiane”.(Evidenca 1.8). DGJH ka hartuar rregulloren e këtij programi dhe ka plotësuar dosjen e tij të plotë (Evidenca 1.4/1.8).</p> <p>Planit mësimor i programit reflekton ndarjen e lëndëve dhe moduleve përkatëse sipas kategorive lëndore dhe pasqyron ngarkesën e tyre në kredite të shprehur në teori/praktikë, në orë të studimit në auditor dhe orë të studimit individual, në përputhje me përcaktimet ligjore në nenet 70, 73 të ligjit 80/2015 dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të vlerësuara në kredite bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve ETC.</p> <p>Programi përmban kategoritë e veprimtarive formuese (lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese, detyrime përmblyëse) që karakterizojnë programin Bachelor. (Evidenca 1.4)</p> <p>Programi ka 22 lëndë, një pjesë e të cilave përmbajnë module. Kreditet përkatëse variojnë nga, 3 ETC, 4 ECTS, 6 ETC, 7 ECTS dhe 8 ECTS (Evidenca 1.8).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi është hartuar në reference të nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe synon formimin e specialistëve të gjuhës italiane me njohuri të thelluara në gjuhësi, kulturë, qytetërim dhe letërsi italiane. Ai synon gjithashtu pajisjen me shprehje komunikimi, shkrimi dhe përkthimi që mundësojnë profesionalizëm në specialitetet mësues, përkthyes/interpret, kritik letrar. (Evidenca 1.4/ 1.8- Shkresa nr. 240/3, dt. 24.07.2019) Këto njohuri reflektohen në lëndë apo module të formimit gjuhësor, letrar dhe kulturor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në referencë të kriterit të mësipërm, këto njohuri paraqiten në nivel të përparuar dhe synojnë nxitjen e të menduarit kritik në profilet e përmendura dhe aftësimin e kërkimit shkencor të studentit. Programi ka për objekt formimin gjuhësor dhe shkencor me drejtim human, aftësimin për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara në fushat e përkthimit, mësimdhënies, komunikimit dhe studimit gjuhësor dhe letrar në ciklet në vijim. (Evidenca 1.2, neni 2).</p> <p>Duke gjykuar nga përbërja e planit mësimor, reflektimi i tij në programet lëndore, nga literatura shoqëruese dhe nga konstatimet gjatë vizitës, mund të thuhet se programi aplikon në praktikë synimet e shprehura në rregulloren përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse</p>	<p>Programi është hartuar për të ofruar njohuri të thelluara dhe për të zhvilluar kompetencat e studentëve në dy drejtime akademike: gjuhësi teorike dhe e zbatuar dhe studime letrare dhe kulturore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndët karakterizuese plotësojnë formimin në të dyja drejtimet (56 ECTS gjuhësi/32 ECTS kulturë, letërsi);</li> <li>- Lëndët ndërdisiplinore/integruese fokusohen në aspektin praktik</li> </ul>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	të këtij dretjimi dhe në aftësimin gjuhësor në gjuhë të tjera të huaja dhe TIK (1.2 neni 3, neni 5) - Plani parashikon edhe 7 ECTS për provimin e formimit. Ky formim siguron aftësitë bazë të studentit, i cili synon ndjekjen e kurseve më të përparuara studimi në ciklin e dytë. Edhe krijimi i grupeve mësimore brenda njësisë bazë i korrespondon logjikës së krijimit në bazë të këtyre profile duke bërë bashkë staf akademik që i korrispondojnë grupeve me synimin ndër të tjera për të përmirësuar dhe ndjekur mbarëvajtjen mësimore dhe të programit të studimit. (Evidenca I. 2)								
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Ai respekton të gjitha elementet e VKM 41 dt 24.01.2018. Ai përmban: Programi i studimit përmban elementët e mëposhtëm: emërtimin e programit, objektivat formuese, ngarkesën mësimore dhe organizimin e saj në ECTS (planin mësimor), veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë programin, planin mësimor, kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, kuotat dhe kriteret e pranimit, kodin e etikës akademike, detyrimet përmblylëse, profilin e programit, diplomën dhe suplementin. (Evidenca I.8/ II.1). Plani mësimor diskutohet në departament dhe ndryshimet e tij propozohen për miratim në organet më të larta drejtuese ( Tak. 1/ Tak 2/ Tak. 3)								
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi organizohet qartë në veprimtari të klasifikuara sipas kuadrin ligjor të sipërpërmendur: - Lëndë bazë (32 kredite apo 17.7% ECTS), - Lëndë karakterizuese (95 kredite apo 52.7% ECTS), - Lëndë ndërdisiplinore (26 kredite apo 14.4% ECTS), - Lëndë plotësuese (20 kredite apo 11.1% ECTS), dhe - Detyrimet përmblylëse (7 kredite apo 3.8% ECTS) (Evidenca I. 8) Lëndët dhe modulet përbërëse përmbajnë emërtimin, kodin, numrin e krediteve, ngarkesën teori/praktikë, përmbajtjen, literaturën, dhe formën e vlerësimit. Kodi përcakton elementët si më poshtë: - Gjuhën në të cilën zhvillohet kursi apo - Fushën e studimit								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Bazuar në ligjin 80/2015 , neni 22 pika 1, UV është i organizuar në 4 njësi kryesore Fakultete (Evidenca A neni 9) të cilat janë të organizuara në njësi bazë dhe qendra kërkimore (njësi jo bazë) (Evidenca A neni 9,10,11) FSHH që është njësi kryesore përgjegjëse për programin në fjalë ka në përbërje katër njësi bazë: 1. Departamenti i Gjuhëve të huaja, 2. Departamenti i Edukimit, 3. Departamenti i Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, dhe



	<p>4. Departamenti i Drejtësisë. (Evidenca A, neni 9,10)</p> <p>Vetë Departamenti i Gjuhëve të huaja, si njësi bazë që ofron programin Bachelor në “Gjuhë italiane”, ka në përbërje 24 anëtarë personel akademik me kohë të plotë për vitin 2019- 2020: 6 Prof. Asoc.Dr.; 10 Dr.; 2 doktorantë; 6 Msc, 3 anëtarë personel ndihmësakademik, një sekretare mësimore, një sekretare departamenti dhe një laborante. (Aneksi 1 tab 1.1).</p> <p>Në program japin mësim për vitin akademik 2019-2020 9 PAE, nga të cilët 1 Prof. Dr.; 1 Prof.Asoc.; 1 Dr.; 4 Msc dhe 1 doktorant. 1 lektor MAE (doktorant). (Aneksi tabela 6).</p> <p>Departamenti është i organizuar në katër grupe mësimore me karakter kërkimor-shkencor (RVB), përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Grupin e Gjuhësisë;</li> <li>2. Grupi i Studimeve letrare dhe kulturore,</li> <li>3. Grupin e mësimdhënies në gjuhë të huaj, dhe</li> <li>4. Grupi i përkthimit dhe gjuhës së huaj për qëllime të posaçme. (Evidenca I.2 organigrama e DGJH)</li> </ol> <p>Përbërja, funksioni dhe koordinimi i tyre pasqyrohen në Standardin I.4, Kriteri 1 të këtij raporti</p> <p>Departamenti tregon qartë që disponon personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të realizuar programi 2.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Veprimtaria e programit të studimit koordinohet mes përgjegjës të departamentit, përgjegjësve të grupeve mësimore me karakter kërkimor- shkencor dhe koordinatorit me studentët. (Tak.1/Tak.3 dita 1/ tak. 4 dita 2)</p> <p>Përgjegjës të grupeve mësimore koordinojnë veprimtaritë mësimore të stafit dhe studentëve sipas fushave respektive dhe raportojnë periodikisht tek përgjegjësi i departamentit.(Evidenca I.22)</p> <p>Koordinatori për studentët koordinon marrëdhëniet mes studentëve dhe stafit, kryen këshillimin e studentëve në lidhje me kurrikulën dhe raporton për problematika të studentëve në departament dhe te përgjegjësi i departamentit. (Evidenca II. 3/I.22/ Pika. 3/ RVB, Standardi II. 2, kriteri 2)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Organizmi dhe struktura akademike e FSHH përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore sipas ligjit nr. 80/2015, neni 23 dhe udhëzimit nr. 27/2017 të MASR.</p> <p>Organizmi dhe dhe struktura akademike e DGJH përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore të ligjit të larpërmendur, neni 25 dhe udhëzimit 27/2016.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>DGJH përgjegjëse për programin e studimit në shqyrtim përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (neni 25, pika 4) Ai ka në përbërje 24 anëtarë me kohë të plotë: 6 Prof. Asoc; 10 Dr; 2 Doktorantë; 6 asistentë lektorë dhe 1 lektor MAE (doktorant). (Aneksi 1, tabela 1.1, 1.2, 1.3, 1.4)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FSHH ka në përbërje 4 departamente dhe ofron programe në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve (Evidenca Aneksi 1, tab 3.1, 3.2, 3.3, 3.4). Gjithashtu ajo ka një strukturë kërkimore – shkencore që nuk është njësi bazë. (Evidenca A). Struktura akademike përfshin: asamblenë e stafit akademik ku përfshin anëtarë të 4 departamenteve, dekanati dhe përgjegjës të departamenteve. Organizmi dhe struktura akademike përmbushin detyrimet ligjore bazuar në ligjin 80/2015, neni 25 dhe</p>



	udhëzimi 27/2016. Struktura akademike e DGJH përfshin: - Përgjegjësin e departamentit - 4 grupet mësimore /kërkimore shkencore që përbëhen nga PAE. Struktura e DGJH përfshin edhe personel ndihmës.- akademik me karakter akademik. Mund të themi që si struktura e FSHH si e DGJH përbushin kriteret ligjore në fuqi.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Në lidhje me funksionimin dhe menaxhimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë italiane”. (Evidencat A, C, N, I.2, I.3, I.4, I.6, I.7, I.8, II.2), FSHH dhe DGJH disponojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Ky dokumentacion përcakton kornizën ligjore të funksionit të programit, strukturën akademike që e ofron dhe strukturat e tjera mbështetëse, objektivat e programit dhe kompetencat e formimit, kriteret hyrëse, planin mësimor dhe programet lëndore, procedurat e diplomimit dhe formimin profesional të të diplomuarve.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në gjuhë italiane” organizohet në lëndë, module e aktivitete formuese sipas përcaktimëve të VKM nr.41, dt 24.01.2018. Këto veprimtari ndahen në lëndë të detyrueshme lëndë me zgjedhje dhe grupohen në kategoriotë e mëposhtme. <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (32 kredite apo 17.7% ECTS), ku bëjnë pjesë 4 lëndë të detyrueshme me nga 8 kredite</li> <li>- Lëndë karakterizuese (95 kredite apo 52.7% ECTS), ku bëjnë pjesë 12 lëndë të detyrueshme nga të cilat 11 janë me 8 kredite kurse një me 7 kredite. Nga këto lëndë 6 janë organizuar me module me nga 4 kredite secila (4+4)</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore dhe ose integruese (26 kredite apo 14.4% ECTS), ku bëjnë pjesë 3 lëndë nga të cilat një është e detyrueshme dhe tjetra me 8 kredite dhe e përbërë nga dy module të integruara me nga 4 kredite secila.</li> <li>- Lëndë plotësuese (20 kredite apo 11.1% ECTS), ku bëjnë pjesë 3 lëndë nga të cilat 1 është e detyrueshme me 6 kredite dhe dy me zgjedhje, njëra me 6 kredite është e organizuar në dy module të integruara me nga 3 kredite secila dhe tjetra me 8 kredite ne përbërë në dy module të integruar më nga 4 kredite secila.</li> <li>- Detyrimet përmbyllëse (7 kredite apo 3.8% ECTS) provim përfundimtar/ provim diplome. (Evidenca I. 8)</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e	Programi Bachelor në “Gjuhë italiane” (Evidenca I.8) është i organizuar në 180 ECTS në shtrirje tre vjeçare, me gjashtë semestra (15 javë secili) (Evidenca I.8) Kreditet fitohen nga studentët për vlerësimin pozitiv të dijeve të fituara prej tyre. (Evidenca I.2, neni 8) Kjo ngarkesë është e reflektuar në planin mësimor të programit, i cili

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43428

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>semestra.</p>	<p>pasqyron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndarjen në 22 veprimtari sipas kategorive të përcaktuara në Ligjin 80/2015, nenet 6/25, 70,73 dhe VKM nr.41, dt. 24.01.2018 (Standardi II.1,Kriteri 6)</li> <li>- Ndarjen vjetore dhe semestrale të ngarkesës në leksione/seminare, orë në auditor dhe orë jashtë auditorit (përfshi edhe orë e studimit individual - 1830 orë në auditor 2650 jashtë auditorit).</li> <li>- Në vitin e pare studentët zhvillojnë 10 lëndë/module, po kaq në të dytin, dhe 9 lëndë/module plus përgatitjen për provimin e diplomës në vitin e tretë. Të tre vitet reflektojnë lëndë me zgjedhje.</li> </ul> <p><i>Evidentohet</i>  <i>Raporti teori/praktikë i përshtatet deri diku natyrës së lëndëve dhe formimit të kompetencave gjuhësore në këtë program.</i>  <i>Në plan gjithashtu nuk reflektohen orët laboratorike edhe pse gjatë vizitës u konstatua se DGJH ka në përdorim dy laboratorë dhe ka propozuar ngritjen e një të treti në fushën e përkthim - interpretimit. (Evidenca I.8)</i>  <i>Sugjerohet një raport më i drejtë teori/praktikë.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor përfshin të gjitha të dhënat informative të nevojshme në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngarkesën mësimore duke përfshirë këtu si orët në auditor ashtu edhe ato individuale. Raportin lesksion seminar, orët laboratorike, format e kontrollit.</li> <li>- Orët në auditor dhe individuale përbëjnë sasinë mesatare të punës së kryer nga një student gjatë një viti studime në këtë program ecila është 60 kredite X25 ore mësimore për kredit = 1500 orë mësimore punë të studentit. Orët për punë të pavarur zënë jo më shumë se se gjysëm e totalit të orëve vjetore.</li> <li>- Orari mësimor reflekton se ngarkesa mësimore e orëve në auditor për leksione, seminare dhe forma të kontrollit të vazhdueshëm është 25 orë 50-minutëshe në javë. (Evidenca IV.5)</li> <li>- Për vlerësimin e dijeve të fituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhduar më atë përfundimtar. Rregullat për freuentimin/ndjekjen e si dhe vlerësimin e njohurive janë të paraqitura qartë. (Evidenca I.4, neni 7,8,11)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programet e studimi i përmbajnë të gjitha informacionet për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifik të pranimit</p> <p>Rregullorja e programit të studimit dhe programet lëndore përcaktojnë gjithashtu kriteret e frekuentimit dhe instrumentat e vlerësimit, mënyrën e zhvillimit të provimeve. Detyrimet për secilin modul (Evidenca I.2, neni 7 dhe 11/ II.2) .</p> <p>DGJH përcakton notën mesatare të tre viteve të studimit dhe të provimeve të matures, si kriterin e vetëm të panimit në të (Evidenca II.1).</p> <p>Rregullorja përcakton edhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (Evidenca II.9).</p> <p>Pranimi i studentëve bëhet në përputhje me udhëzimet në fuqi të MASR (Tak.5). Njësia përcjell për miratim propozimet për kriteret dhe kuota pranimi dhe transferimi, bazuar në kapacitetet pritëse (Evidenca II.9).</p>



	Pas miratimit në Senat publikohen në portalin U-Albania dhe bëhen publike edhe në faqen zyrtare te Facebook-ut., si dhe promovohen në broshura dhe guidën e studentit (Evidenca II.4/ Tak.1 dita 2).			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës, sipas modelit të paraqitur në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018. (RVB, Anexi 1, Tab 14.1 dhe 14.2). Ato përditësohen në vijimësi sipas parimeve dhe kritereve të legjislacionit në fuqi. (Evidenca II.2/ II.5/ II.7) Në fillim të çdo semestri pedagogu i njeh studentët me programin lëndor dhe veprimtaritë e përfshira në të, me detyrimet dhe përgjegjësitë, me format e vlerësimit dhe provimin final (Tak.3/Tak. 3 dita 2)			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	DGJH përmirëson në vijimësi si kurrikulën ashtu edhe programet lëndore (Evidenca II.7) me qëllim përshtatjet me ndryshimet ligjore dhe përmirësimin e përmbajtjes, literatures dhe metodologjisë. (Evidenca I.22/ Tak. 3 dita 1 ) Propozimet e departamentit për ndryshime në kurrikul (deri në masën 20%) kalojnë në Senatën Akademik. Ndryshimet kryesore në program janë bërë me qëllim përputhjen me legjislacionin në fuqi. (Evidenca I.7/I.13/ Tak.1)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Bazuar në Standardin II.3, kriteri 2, mund të thuhet se ngarkesa e programit të studimit Bach. në "Gjuhë italiane" është strukturuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Për më tepër, ngarkesa e programit shtrihet në gjashtë semestra 15-javorë me 3-4 javë sezon provimesh në secilin vit akademik. Ngarkesa mësimore javore në auditor (leksione, seminare) nuk e tejkalon 25 orë mësimore (Evidenca I.4 neni 1/ II.8) Programi përmban 23 lëndë: 4 lëndë bazë semestrare; 12 karakterizuese, prej të cilave 6 të organizuara në module, njëra në module të integruara të shtrirë në një semestër, 5 të tjerat në module të ndara në dy semestra; 4 ndërdisiplinore/ integruese semestrare, nga të cilat njëra lëndë është me module të integruara; 3 plotësuese semestrare, nga të cilat 2 me module të integruara. Ngarkesa mësimore javore në auditor është mesatarisht 21 orë në javë në përputhje me pikën 2.1/d në VKM 41/2018. Sasia mesatare e punës që kryen studenti është 60 kredite në vit. (Evidenca I.8)
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi i lëndëve jo gjithmonë reflekton përmbajtjen e tyre (Evidenca I.4, neni 5) pavarësisht faktit që përmbajtjet përkojnë me objektivat formuese të programit të studimit: njohuri gjuhësore, kulturore dhe letrare në gjuhën italiane, njohuri të letërsisë e studimeve kulturore, si dhe aftësi komunikimi dhe përkthim/interpretim. (Evidenca I.8) Komponentët mësimorë të mësimin në auditor (leksione, seminare)



	<p>nxisin aftësimin praktik dhe përdorimin profesional të gjuhës italiane në specifikat e fushave të mësipërme. Këto reflektohen në syllabuset lëndore përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Kurrikula është e hartuar në përputhje me profilin e programit. Shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra pasqyron arritjen e kompetencave të synuara të programit (Evidenca I.8) dhe thellimin e njohurive nga viti në vit.</p> <p>Lëndët e vitit I janë kryesisht lëndë bazë dhe plotësuese dhe synojnë kompetencat bazë gjuhësore.</p> <p>Lëndët e viti II janë kryesisht karakterizuese dhe synojnë kompetencat hulumtuese dhe përsosjen e shprehive gjuhësore, letrare dhe kulturore.</p> <p>Lëndët e vitit III thellojnë formimin profesional në komunikim, përkthim (Evidenca I.8)</p> <p>Ngarkesa në kredite reflekton sasinë e punës në auditor dhe ngarkesës individuale që i duhet studentit për të arritur rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> <p><i>Evidentohet</i></p> <p><i>Pavarësisht faktit që është bërë përpjekje që raporti teori/praktikë të jetë barabartë kjo në disa lëndë nuk pasqyron një raport fort të drejtë të tyre, kërkesë kjo edhe e studentëve në pyetësorët përkatës në lidhje me disa lëndë që rezultojnë të vështira për t'u kuptuar për shkak të mbingarkesës teorike.</i></p> <p><i>Rekomandohet një raport më i drejtë i tyre.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit është organizuar në referencë të profilit të programit, formimit të specialistëve të gjuhës italiane (Evidenca I.4/ I.8) Profili kulturor dhe profesional i studentit, KSHK-së dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. (Evidenca I.8).</p> <p>Ka kontroll të vazhdueshëm të dijeve që realizohet gjatë gjithë vitit përmes provimeve e detyrave. (Evidenca I.4),</p> <p><i>Evidentohet</i></p> <p>1. <i>GVJ rekomandon rishikimin e përmbledhjeve të lëndëve të paraqitura në Evidenca Duhet të kenë një format të përbashkët paraqitje, të paraqesin qartë atë çfarë ato përmbajnë shkurtimisht, pasi tematikat e detajuara janë të qartësuara në syllabuse. Një pjesë janë shumë përgjithësuese. (Evidenca I.4) e mjaft të shkurta:</i></p> <p><i>ITA 151, ITA 255, ITA 193, ITA 332, GER 132, GER 344, SPA 344.</i></p> <p><i>Rekomandohet vendosja e kritereve paraqitëse formale për të gjitha përmbledhjet.</i></p> <p>2. <i>Syllabusi ITA 170 nuk i përmbahet formatit të përcaktuar nga kuadri ligjor. Kodi është ekzistues por titulli i lëndës mungon. Përmbajtja në tematika për 45 orë lex/45 sem lë për të dëshiruar. Ka një numër shumë të madh orësh të pajustificuara për një lëndë të kësaj natyre që duhet të jetë shumë praktike dhe me tema mjaft të larmishme motivuese e nxitëse me qëllim zhvillimin e aftësië së shkrimit.</i></p> <p><i>Ajo paraqet gjithashtu një numër shumë të madh kreditesh 8 ETC, pavarësisht që është e ndarë në dy module. Gjithashtu moduli i dytë i kësaj lënde Shkrimi Akademik as që mund të konceptohet për studentë të vitit të parë ndaj kjo lëndë duhet riparë dhe riprogramuar krejtësisht. (Evidenca I. 8), Nëse duhet konsideruar që është zhvillimi i aftësisë së të shkruarit, lënda duhet të jetë e formatit shumë më tepër praktik se teorik. Aftësia e të shkruarit ka nevojë të zhvillohet nëpërmjet punës praktike direkte ushtrimore. Lënda mund të jetë tërësisht me</i></p>



karakter praktik dhe të konceptohet ne dy module si Gjuhë e Shkruar dhe Gjuhë e Folur, aftësi këto të domosdoshme t'u zhvilluar sidomos për studentë të vitit të parë.

3. GVJ duke parë praninë e lëndëve me shumë kredite, rekomandon një shpërndarje kreditesh më të drejtë me fokus harmonizimin ndërmjet lëndëve dhe jo vetëm, kjo pasi numri i madh i krediteve në një lëndë sjell një numër të madh leksionesh dhe seminaresh gjë që mbingarkon lëndën e si rrjedhojë pedagogun dhe studentin. Rekomandohet një larmi më e madhe lëndësh, të nevojshme për formimin e studentëve të këtij programi. Rekomandohet shtimi i moduleve më praktike dhe më pak teorike. Këshillohet kalimi i disa lëndëve që janë karakteristike për formimin specifik profilizues në master.

- Këshillohet zëvendësimi i disa lëndëve shumë teorike gjuhësore me lëndë me karakter më praktik që zhvillojnë shumë më tepër aftësitë bazë gjuhësore.

Këshillohet kalimi i disa lëndëve në Master si:

1. TIK (është profilizuese)
2. Metodologji e mësimdhënies (kërkon formim bazik paraprak të studentit dhe është lëndë profilizuese)
3. Gjuhësi e aplikuar (kërkon formim të plotë paraprak të studentit) dhe nuk mund të jetë lëndë me zgjedhje. Ajo duhet të jetë e detyrueshme. Është lëndë bazë për formimin e mësuesit

Arsyetimi: dy lëndët me karakter gjuhësor kërkojnë një formim bazë të plotë të studentit e cila mundësohet në Bachelor. Vetëm pas një formimi të tillë studenti mund të jetë i aftë në studimin e këtyre lëndëve.

-Lënda Metodologji e Mësimdhënies është një lëndë specifike që për natyrën që ka i drejtohet mësuesit të gjuhës së huaj dhe gjithashtu kërkon një formim paraprak të studentit me nocione bazë të cilat lidhen me Didaktikën e gjuhëve të huaja (brenda syllabusit ka nocione të Didaktikës të nevojshme për formimin bazë dhe i referohet shumë pak metodave ndaj rekomandohet ndryshimi i emërimit të lëndës dhe dhënia e njohurive bazë që mundësojnë formimin për ciklin e dytë të studimeve që është i profilizuar dhe profesional për mësuesin)

-Lënda TIK është një lëndë specifike profilizuese-profesionale për mësuesin e gjuhës ndaj me një profilizim të karakterit të saj ajo rekomandohet të kalohet në ciklin e dytë dhe kategorizimi i saj është A/B, ndaj nuk mund të jetë një lëndë me zgjedhje (syllabusi brenda tij paraqet shumë pak nocione që lidhen me përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në funksion të mësuesit dhe mësimdhënies, brenda tij paraqiten bazat informatike të mirëfillta, ndaj mund të konsiderohet si e tillë). Kjo lëndë në fakt del me dy emërtime të ndryshme. Në planin mësimor del me emërtimin Shkenca kompjuterike ndërsa brenda në syllabus paraqitet si TIK dhe përmbajtja është informatikë kompjuterike. Rekomandohet rishikimi i emërimit dhe konceptimi i lëndës TIK në Master.

Këshillohet rishikimi i emërtimeve të lëndëve:

1. Gjuhë italiane e avancuar 1,2,3 në (Gjuhë italiane 1, 2,3)-termi i "avancuar" nuk mund të përkojë me nivelit përkatës kur flitet për vitin e parë dhe nivel gjuhe A1- A2, B1-B2. Ai duhet t'i referohet niveleve përkatëse. (në përmbledhjen e lëndës Ita 144. Lënda thotë "kurs i nivelit mesatar" duke rënë



	<p><i>në kundërshti me emërtimin dhe nivelin.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. <i>Metoda të mësimdhënies në Didaktikë e Gjuhës B</i></li> <li>3. <i>Lënda studime komunikimi në Hyrje në teorinë e komunikimit (pasi studime komunikimi koncepton studim dhe njohje paraprake të nocioneve që kalojnë në studime të mëtejshme)</i></li> <li>4. <i>Lënda Shkenca Kompjuterike në Informatikë apo Laborator informatike.</i></li> <li>5. <i>Lënda Arti i të Shkruarit (ndarë në dy module) mund të konceptohet në Gjuhë e Shkruar dhe Gjuhë e Folur.</i></li> </ol> <p><i>Këshillohet futja e lëndëve apo moduleve për ta bërë programin më të larmishëm por edhe shumë më praktik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Gjuhë latine</i></li> <li>- <i>Gjuhë e folur/ Laborator i të folurit</i></li> <li>- <i>Tipologji apo analizë teksti</i></li> <li>- <i>Studim/analizim/ shpjegim vepre</i></li> <li>- <i>Praktikum gjuhe</i></li> </ul> <p><i>Kjo duke parë domosdoshmërinë e një formimi të përgjithshëm dhe shumë më praktik se teorik të studentëve dhe për reduktim të lëndë shumë gjuhësore.</i></p> <p><i>Rekomandohet gjithashtu që në kuadrin e hartimit të detyrave të kursit mos të përjashtohet puna në grupe gjë që tashmë është fort e rekomanduar nga glotodidaktika botërore</i></p> <p><i>Programi nuk reflekton ngjashmëri të konsiderueshme me programe simotra në vend.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron një harmonizim dhe një përafrim më të plotë të programit të studimit me ato të programeve të departamenteve simotra të LAL në vend pasi kjo do të mundësonte një formim sa më të përafërt të studentëve që studiojnë në Shqipëri, transferimin e natyrshëm të tyre në LAL e tjera dhe vijimin e studimeve në cikle të ndryshme studimi duke iu përshtatur më së miri nevojave të përgjithshme dhe specifike për formimin e tyre.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në Standardin II.1, kriteri 4 dhe 6 i këtij raporti, mund të thuhet se ndarja e veprimtarive formuese mundëson arritjen e objektivave të programit dhe mundëson deri diku procedurat e transferimit, mobilitet e studentëve. Kjo lloj ndarje mundëson edhe zhvillimin e kompetencave profesionale në fushat të ndryshme të lidhura me tregun e punës dhe kërkesat e tij. (Evidenca I.10)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimit të zhvilluar (tak 1, tak 3) me përgjegjësën e departamentit dhe me pedagogët që mbulojnë lëndë në këtë program studimi u konstatua se programet lëndore përditësohen me qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rishikimin dhe përditësimin e kurrikulës (Evidenca II.7) dhe</li> <li>- përditësimin e përmbajtjes dhe literaturës së modulit/lëndës</li> </ul> <p>Kjo zhvillohet në fillim të çdo viti akademik duke pasur si synim edhe sugjerimet e studentëve në pyetësorë.</p> <p>Literatura në dispozicion të lëndës rezulton e përditësuar dhe e bollshme deri diku.</p> <p>Ajo miratohet nga Komisioni i Miratimit të Teksteve në DGJH. (Evidenca II.10 RVB).</p> <p>Studentët mund ta gjejnë edhe në bibliotekat e njësisë, të fakultetit dhe të universitetit (Tak.7)</p> <p><i>Evidentohet</i></p>



	<i>Në disa raste ka literaturë që nuk i takon 5 viteve të fundit siç dhe kërkohet ndaj rekomandohet përditësimi i tyre.</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Përbajtja e lëndëve përbërëse në kurrikul garanton përfundimin e dijeve, dhe kompetencave të synuara nga programi, të cilat për një program të ciklit të parë synojnë kompetencat bazë gjuhësore, kulturore dhe letrare në gjuhë italiane. (Evidenca I.2/ I.8) Fokusi i studimit është marrja e njohurive dhe kompetencave bazë gjuhësore, të fushës profesionale dhe të dijeve dhe të aftësive korrisponduese të përshtashme për ciklin e parë të studimeve. Kështu lëndët i përgjigjen një apo më shumë kompetencave që shërbejnë për formimin e mësipërm dhe aftësimi i aplikimit të tyre në kërkim dhe në punësim të mundshëm pas diplomimit. (Evidenca I.2)			
<b>Kriteri 8.</b> Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit mundëson vijueshmërinë e mëtejshme të studimeve në ciklin e dytë (Evidenca I.25) Kurrikula në tërësi ofron nivelin bazë të njohurive në fushat e gjuhës dhe gjuhësisë italiane, përkthim/interpretim dhe mësimdhënie e gjuhës së huaj (kjo e fundit ka 7 ECTS dhe ofrohet si lëndë karakterizuese- për referencë Standardi II.1, kriteri 4). Dy profilet e fundit ofrohen nga DGJH në ciklin e dytë, respektivisht si programe të Masterit Shkencor dhe Master Profesional. Formimi i studentëve në këtë profil të ciklit të parë mundëson fillimisht punësim në përkthim dhe interpretim dhe në promovion turistik dy profile që i përshtaten më së miri sidomos zonës në fjalë.			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Programi përmirësohet në vijim të bashkëpunimit të NJBSC me Drejtorinë e Edukimit, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Veprimtaritë që njësisia organizon në bashkëpunim me partneret e tregut në këtë drejtim mund të jenë më të shpeshta e më të shumëllojshme. Kështu evidentohet organizimi i workshop më datë 18.12.2019 (Evidenca I.12) që ka pasur si qëllim pikërisht përmirësimin e programeve në përshtatje të vazhdueshme me tregun e punës, ku pjesëmarrja e ekspertëve të jashtëm të bizneseve, institucioneve publike dhe private ishte një përvojë që i mundësoi njësisë të kuptojë realitetin e tregut të punës të kërkojë sugjerime dhe të vërë ato në praktikë për një përshtatje sa më të mirë të programeve mësimore me kërkesat e tregut të punës. Megjithatë fakti që programi (si program i ciklit I) ofron nevojën e studimeve të profilizuara të mëtejshme, e bën të vështirë përthithjen e drejtpërdrejtë të ekspertizës së aktorëve të mundshëm të tregut. Kjo bëhet nga DGJH në vijim të përditësimit të kurrikulave të ciklit të dytë. Gjithsesi aktualisht DGJH ofron dy programe “Masteri profesional” për mësuesi CLAB në gjuhën italiane dhe atë angleze dhe një program Master i shkencave në “Përkthim – interpretim”. Këto mastera, të cilët i përgatisin studentët profesionalisht në fusha të caktuara i mundësojnë atyre punësim sidomos për faktin e pranisë së shumë firmave italiane në vend, mësimdhënies në arsimin publik dhe privat, përkthimeve të dokumentacioneve të ndryshme dhe pranisë së turistëve.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
		X		

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin**



**e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi që mbulon programin është i gjithi me kohë të plotë dhe i përket kategorisë “profesor”, “lektor” dhe “asistent-lektor”.</p> <p><i>Një anëtar- stafi gjithashtu është folës i gjuhës amtare (italisht) i mbështetur nga Ministria e Jashtme Italiane, gjë që GVJ e konsideron shembull të praktikës së mirë, në mbështetje të objektivave formuese të programit. Ndarja e personelit në grupe mësimore me karakter kërkimor-shkencor, është shembull i një praktike shumë të mirë i cili siguron angazhim akademik të personelit në mbulimin e kurrikulës sipas profilit përkatës. (Evidenca I.8/ I.18)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik në këtë program studimi është i gjithi me kohë të plotë, nuk ka në përbërje të tij personel akademik më kohë të pjesshme. Personeli me kohë të plotë angazhohet si personel me kontratë të caktuar dhe të pacaktuar.</p> <p>Ngarkesa e stafit reflekton balancim në njësi dhe përkon me kuadrin ligjor në fuqi (Evidenca II. 12).</p> <p>Në përbërje të tij ky staf ka 1 Prof. Dr, 2 Prof Asoc, 1 doktorant, 5 Msc, dhe 1 lektor i huaj doktorant.</p> <p>Fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në program është në përputhje me natyrën dhe specifikat e moduleve që mbulojnë. Nga shqyrtimi i CV-ve del qartë që orientimi i studimeve të tyre pasuniversitare përkon me ekspertizën në fushat respektive në kurrikul. Kërkimi shkencor e tyre i evidentuar, pjesëmarrja në konferenca, kumtesat dhe artikujt e botuar të çdo anëtari të personelit janë të drejtuara në fushat përkatëse studimore dhe mësimdhënëse. (Evidenca II .12)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në program kualifikohet vazhdimisht më tej në disiplinat përkatëse (Evidenca II.12) dhe angazhohet në aktivitete kërkimore, boton rezultatet e kërkimit shkencor dhe inicion projekte për stafin dhe studentët.</p> <p>Niveli i tyre i kualifikimit është i tillë që iu mundëson një performancë mësimdhënie cilësore.</p> <p>Pjesëmarrja në konferenca, botimet dhe mobilitetet janë tregues i një formimi të personelit në mënyrë të vazhdueshme dhe cilësore. Ky personel angazhohet në organizimin e aktiviteteve shkencore dhe realizon botime në përputhje me programin e studimit , merr pjesë dhe niston projekte shkëmbimi për stafin dhe studentët.</p> <p>Erasmus + (Evidenca I. 16)</p> <p>(Statistika, <a href="https://univlora.edu.al/selktori-projekteve/statistika/">https://univlora.edu.al/selktori-projekteve/statistika/</a> (RVB) (Tabela me marrveshjet ndwristitucionale KA107) , <a href="https://univlora.edu.l/wp-content/plugins/ari/fancybox/assets/pdfs/web/viewer.html?file">https://univlora.edu.l/wp-content/plugins/ari/fancybox/assets/pdfs/web/viewer.html?file</a> (RVB)</p> <p>Ndër konferencat evidentojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konferenca ndërkombëtare me temë “Studi italiani nei Balcani: prospettive passate, presenti e future sul ruolo dell’italia verso l’integrazione dei Balcani in UE”. <a href="https://sites.google.com/a/univlora.edu.al/italian-studies-in-the/">https://sites.google.com/a/univlora.edu.al/italian-studies-in-the/</a> (RVB)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të</p>	<p>Programi nuk përmban komponentë të praktikës profesionale për shkak të natyrës dhe objektivave të tij formuese.</p> <p>Për udhëheqjen dhe mbikqyrjen e studentëve për punimin e diplomës në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>këtë program, DGJH ndjek procedurat dhe kriteret e miratuara në rang njësie (Evidenca I.4, neni 13/ II.14) dhe në rang insitucional VA nr.65, dt 14.11.2016)</p> <p>Pavarësisht këtij fakti DGJH në lidhje me programin e gjuhës italiane angazhohen në veprimtari të tjera që lidhen ngushtë me programin e studimit. Këto aktivitete që janë të larmishme janë të lidhura kryesisht me Konsullatën italiane. (Evidenca II.14) etj.</p> <p>Në lidhje me punimin e diplomës, studenti duhet të përmbushë kriterin e notës mesatare 9 (Vendimi i SA 09/2017), paraqet një projekt-propozim sipas standarteve (Vendim SA n.65/2016) qe i gjen të publikuara online në faqen e UV.</p> <p>Gjithashtu edhe stafi akademik që udhëheq studentin në diplomë duhet t'i përmbahet specifikave dhe kërkesave në lidhje me atë çka duhet të paraqite në punim dhe për çfarë shërben ajo si dhe ta drejtojë studentin deri në fund më qëllim që punimi të jetë jo vetëm i hartuar sipas standardeve të përcaktuara por të përmbushë misionin që ka përcaktuar që në fillim. (Evidenca N).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e formimit praktik të studentëve, DGJH përdor tre salla multifunkionale të pajisura për praktikimin e lëndës së fonetikës dhe intepretim - përkthimit (Evidenca III.12).</p> <p>Për mirëmbajtjen e tij është angazhuar personel ndihmës akademik, laborant, me formim në gjuhë të huaj (Evidenca N). Aktualisht DGJH nuk ofron orë të mirëfillta laboratorit, me programe specifike të mësimin të gjuhëve të huaja.</p> <p>Megjithatë, njësia ka hartuar tashmë një projekt-propozim për ngritjen e laboratorit të përkthimit, i cili do të ndihmojë aplikimin praktik të njohurive teorike që studentët marrin në këtë program, në kuadër të njërit prej objektivave kryesorë të këtij të fundit.</p> <p><i>Rekomandohet ngritja sa më parë e laboratorit të përkthimit, i domosdoshëm për zhvillimin e kompetencave të nevojshme përkthimore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	---	------------------------------

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel insitucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në</p>	<p>Bazuar në evidencën N, UV ka miratuar (me vendimin e datës 13.01.2020) dhe zbaton “Udhëzuesin në nivel insitucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit”. Përmes tij UV synon të formojë një sërë vlerash insitucionale përmes rritjes së cilësisë së</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>mësimdhënies (Evidenca N.)  Ndër objektivat e këtij Udhëzuesi janë shkëmbimi dhe zbatimi i ideve dhe përvojave rreth kalimit në mësimdhënie me në qendër studentin, mbështetja e inovacionit në mësimdhënie në përputhje me tendencat evropiane, nxitja e bashkëpunimit në nivel rajonal për inovacionin në mësimdhënie, etj. (Evidenca N)  Udhëzuesi është një ndihmë për stafin e UV për të përmirësuar dhe rishikuar vazhdimisht mësimdhënien dhe metodologjitë e përdorura për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Statuti i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë (Evidenca A), përcakton qartë elementet e sigurimit të cilësisë në institucion.  Bazuar në Statutin e UV, nenet 81, 82 dhe 83, përcaktohen parimet, mekanizmat dhe përbërja e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë që e mbështet punën e tij në vlerësimin periodik në lidhje me përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, është një nga mekanizmat kryesorë që monitoron në vijimësi punën e personelit akademik dhe atij ndihmës.  Kjo njësi harton raporte vjetore në lidhje me:  1. pyetësorët drejtuar studentëve  2. veprimtarinë e UV  Këto raporte kanë si qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar kështu pikat e forta dhe të dobëta që dalin në pah.  Këto raporte të cilat pasqyrojnë statistikisht të dhënat e mbledhura, analizën e këtyre të dhënave janë një mjet shumë i rëndësishëm për njësitë bazë dhe i orientojnë ata në punë e tyre për një përmirësim të vazhdueshëm në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë.  Bazuar në këto raporte NJSBVCI jep dhe ofron propozime apo sugjerimet e rastit për përmirësimin e cilësisë. (Evidenca J, III.2, K, L, III.3).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UV parashikon përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve parashikohet në disa dokumente të institucionit. Kështu, në Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë (Evidenca C), nenin 62, parashikohet e drejta e studentit për ankimin e rezultatit përfundimtar. Aty paraqitet edhe procedura që duhet të ndiqet në këtë rast. Duhet theksuar gjithashtu edhe pjesëmarrja e studentëve në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Aneksi tabela 24). Duhet vënë gjithashtu në dukje edhe Vendimi i Senatit nr. 94, datë 13.10.2017 “Për një adresë të posaçme elektronike për adresimin e ankimeve dhe shqetësimeve të studentëve dhe stafit akademik” (Evidenca III.6). Vendimi nr. 21/2018, përcakton gjithashtu procedurën e vlerësimit dhe analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. (Evidenca III.3).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBVCI si strukturë përgjegjëse në UV për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie publikon në mënyrë periodike raportin e analizës së pyetësorëve për vlerësimin e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi së bashku me rekomandimet përkatëse. Këto publikohen në faqen e universitetit. Ky publikim respekton etikën dhe lirinë akademike si dhe ligjin 987/ 2008, ndryshuar me ligjin 48/2012. (Tak 5 dita 1)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira,</p>	<p>UV çdo vit përpilon raportin vjetor (Evidenca J) i cili është dëshmuar i përpjekjes serioze për ta parë ecurinë e punës së stafit akademik dhe ndihmës akademik si dhe tërë mbarëvajtjes mësimore. Edhe DGJH gjithashtu çdo vit organizon analizën vjetore të punës, një nga pikat e së</p>



nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	cilës është edhe analiza e cilësisë së mësimdhënies. Kjo evidentohet edhe në Analizën vjetore të DGJH-së (Evidenca J, I. 22). Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, përgjegjësi i grupit mësimor me karakter kërkimor-shkencor bën vlerësimin e performancës të secilit anëtar të grupit dhe UV në mënyrë të vazhdueshme promovon praktikën dhe përvojat e mira përmes vlerësimeve të posaçme. (Evidenca III 8)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikën profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në DGJH rregullorja e departamentit (Evidenca I.2) dhe rregullorja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca I.4.) përcaktojnë qartë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive të cilat reflektohen në programet lëndore të programit (Evidenca II.2). Bazuar në nenin 16 (pikat 4 dhe 6) i Rregullores së Departamentit të Gjuhëve të Huaja përcaktohen qartë format e mësimdhënies dhe mësimnxënies të parashikuara nga ky kriter. Aty përfshihen leksionet, seminarët, laboratorët, punime relacionesh, detyra e kursit apo projekte mësimore, ese, prezantime përgatitje e temës së diplomës, etj. (Evidenca I. 2).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Rregullorja e Departamentit të Gjuhëve të Huaja (Evidenca I.2) parashikon gjithashtu aktivitete alternative didaktike dhe kërkimore. Këtu përfshihen leksionet me lektorët e ftuar (Evidenca III.9) punët kërkimore, botimet, projekte, prezantime (Evidenca II.13), etj. Gjithashtu në të gjitha këto veprimtari stafi përfshin edhe studentët duke i bërë ata pjesë e pandarë e jetës akademike. (Konferenca studentore)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	UV zhvillon shërbim edukimi akademik veprimtari shkencore dhe kërkimore, mbështetje dhe këshillim profesional për studentë dhe kërkues në fusha të ndryshme. Roli dhe misioni i UV bazuar në Planin Strategjik 2018-2024 (Evidenca B) të institucionit, mbështetet mbi disa shtylla kryesore të cilat përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- mësimdhënien dhe studimin;</li> <li>- edukimin e vlerave;</li> <li>- kërkimin shkencor;</li> <li>- bashkëpunimin;</li> <li>- sigurimin e cilësisë dhe standardeve;</li> <li>- bashkëpunimin e partneritetin;</li> <li>- ndërkombëtarizimin etj.</li> </ul> Një nga mjetet më efikase është ai i mobilitetëve dhe për këtë DGJ shquhet më së miri. Institucioni në funksion të përmirësimit të kompetencave didaktike dhe mundësimin e përdorimit të metodave të shumëllojshme dhe fleksibile

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit dhe objektivat formues, ka lidhur marrëveshje për mobilitete akademike si dhe marrëveshje ndërinstitucionale. (Evidenca I.16). Kështu çdo staf akademik ka pasur minimalisht një përvojë shkëmbimi për mësimdhënie apo trajnim. E gjitha kjo mundësohet bazuar në Udhëzuesin për Zhvillim të UV.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	DGJH ka në përberje të tij 24 personel akademik si dhe personel ndihmës akademik 3 punonjës Personeli akademik i cili është personel efektiv me kohë të plotë i DGJH i plotëson të gjitha kriteret ligjore të kualifikimit pasi ka formim të tillë që mundëson dhënien cilësore të njohurive të nevojshme për lëndët përkatëse, është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Kjo gjë është e verifikueshme dhe vërtetohet edhe nga CV-të e stafit akademik (Evidenca II.12), ku paraqitet qartë përvoja dhe kualifikimet përkatëse. Kjo reflektohet edhe në procedurën e punësimit të stafit akademik. (Evidenca III.10 Tak 1 dita 2). Gjithashtu edhe nga rezultate e pyetësorëve drejtuar studentëve rezultojnë që 77.9% e tyre mendon që pedagogu përpikëqet ta bëjë lëndën interesante, 77.8% që pedagogu është i përgatitur. Gjithashtu edhe rezultate të tjera të këtyre pyetësorëve tregojnë që pjesa më e madhe e studentëve mendon që pedagogu inkurajon, motivon, nxit dialogun/diskutimin dhe mendimin kritik. (Raporti i Analizës së pyetësorëve). Gjithashtu kërkimi shkencor, botimet, pjesëmarrja në konferenca etj. tregon rritje të kërkesës së personelit për përmirësim të mëtejshëm të aftësive dhe kompetencave të tyre mësimdhënëse.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Në evidencat (Evidenca L, M) di dhe gjatë takimit me përgjegjësen e Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe personelin akademik (Tak 1,8 dita 1), konstatoam se matja dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira përfshihen në raportin e analizës së pyetësorëve. Raporti i analizës së pyetësorëve (Raporti i analizës së pyetësorëve fq 75, <a href="https://uni.enivlora.edu.al">https://uni.enivlora.edu.al</a> ) i kryer nga NJSBVCI ka pikërisht për qëllim matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies. Ky raport përcillet më pas tek secili prej anëtarëve të personelit akademik i angazhuar në programin e studimit i cili në mbledhje departamenti vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke reflektuar mendimet e sugjerimet e studentëve. (Evidenca III.2)
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Bazuar në përdorimin e metodave interaktive dhe nxitëse (62% e studentëve mendojnë që mësimdhënia është pikërisht e tillë. Kjo doli në pah edhe në takimin e organizuar me studentët (Tak 3 dita 2), ata u shprehën se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane” përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin duke nxitur kurajon, dialogun dhe diskutimin pozitiv në klasë dhe 57% mendon që zhvillon mendimin kritik. Edhe përdorimi i suporteve teknologjike mbështetëse dhe përdorimi i laboratorëve ekzistues është pikërisht në funksion të këtij qëllimi.
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të	Në programet e lëndëve (Evidenca II.2) që janë pjesë e programit të studimit reflektohet një qasje didaktike që nxit autonominë e studentit. Gjatë përgatitjes së detyrave apo projekteve dhe punës së tyre individuale apo në grup pavarësisht nxjitjes së autonomisë (Evidenca I.2) së studentit pedagogu është mbështetës dhe lehtësues i rugëtimit personal të nxënësit. (Evidenca I.2). Kjo mundësohet me anë të çdo lloji mjeti komunikimi të mundshëm me qëllim që studentit të ketë suportin e



ndërsjellë mes tyre.	vazhdueshëm nga pedagogu për të gjitha vështirësitë që mund të hasë apo që t'i ofrojë atij strategjitë që i nevojiten për zgjidhjen problematikave të hasura. Gjithsesi nga analiza e pyetësorëve dhe përqindjet tregojnë që ka vend akoma për përmirësim në këto aspekte.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Hapësirat mësimore dhe kërkimore – shkencore mundësohen në mjedise me hapësira të bollshme të ndriçuara dhe të pajisura. Godina që i përkasin ato është krejtësisht e rikonstruktuar. Godina ka një sipërfaqe 3040 m <sup>2</sup> . Hapësira të brendshme dhe 2000 m <sup>2</sup> hapësira plus aktivitete sportive e aktivitete të tjera. Nga turi virtual i zhvilluar, (Tak 7 dita 1) u njohëm me ambientet e institucionit në dispozicion të realizimit të programit të studimit. Konstatuam se hapësirat si në dispozicion të studentëve 2.8 m <sup>2</sup> /student (ashtu edhe të personelit 10.3 m <sup>2</sup> për person (Aneksi 1 RVB) në dispozicion plotësojnë kushtet e kërkuara për realizimin e procesit mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Gjatë turit virtual konstatuam se përveç klasave për leksione dhe seminare, DGJH realizon procesin mësimor në dy laboratorë (fonetike/informatike dhe sallë për praktikë lëndore/ profesionale). Që janë të pajisura me logjistikën e nevojshme në mbështetje të procesit mësimor dhe kërkimor. Gjithashtu, Këndi i Leximit dhe Biblioteka e UV është një tjetër mjedis që shfrytëzohet nga studentët në funksion të procesit mësimor. Ato janë të pajisura me një fond librash në gjuhë italiane dhe angleze në mbështetje të kërkimit shkencor dhe literaturës së nevojshme në mbështetje të procesit mësimor. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, përfshirë dërrasë të zezë, ëhite board, videprojektor, perde video projektimi etj. (Evidenca III.11, Evidenca III.12)
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV-së” UMVS, (Evidenca III.13), është një sistem mjaft i nevojshëm dhe përdoret për menaxhimin e procesit mësimor nga personeli akademik dhe studentët. Studentët dhe personeli akademik shfrytëzojnë kështu infrastrukturën e IT së UV e cila (Ankesi1) përdoret për menaxhimin e procesit mësimor nga personeli akademik dhe studentët. Gjatë turit online në mjediset e fakultetit, u konstatua që funksionon lidhja e internetit ëireless në mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane. Gjithashtu, siç paraqitet në manualin e përdorimit të UMVS (University of Vlora Management System) (Evidenca III.14), stafi dhe studentët janë të pajisur me adresat e tyre zyrtare të postës elektronike. Gjithashtu në UV ka një personel të sektorit IT për një asistencë më imediate e më të plotë për këdo.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të	Studentët kanë mundësi të sigurojnë literaturën bazë jo vetëm në formë fizike pranë bibliotekave por edhe elektronike. Biblioteka e UV i

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>garanton studentëve një numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit (Evidenca III.15)</p> <p>Në bazë të Rregullores së UV “tekstet mësimore .... duhet të miratohen nga departamenti me propozimin e titullarëve” dhe Komisioni i Teksteve për DGJH kryen pikërisht vlerësimin dhe aprovimin e tyre (RVB)</p> <p>Gjatë takimit me studentët (tak 3 dita 2), por edhe nga turi online në bibliotekën e Fakultetit dhe të UV, rezultoi literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) ndihmon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane”.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Turi virtual që u zhvillua në bibliotekë në dispozicion të programit të studimit si dhe nga shqyrtimi i Informacionit për Sektorin e Bibliotekës (Evidenca III.15), rezultoi që UV ka në dispozicion të pedagogëve studentëve dhe studiuesve 3 biblioteka ( A, B, C) dhe 3 salla leximi. Numri i vendeve në total është 120 për të 3-ja bibliotekat. Në lidhje me numrin e vëllimeve që përmban secila prej tyre ai ndryshon vit pas viti si rrjedhojë e prurjeve të reja të përfuara nga dhurimet e blerjet. Në total fondi i trashëguar për vitet 1994- 2016 është 35 mijë tekste në kopje. Nga viti 2016- 2018 janë kryer dy blerje që kanë pasuruar më tutje me 568 tituj të rinj këto biblioteka me literaturë bashkëkohore. Biblioteka i ofron studentëve mundësinë e shfrytëzimit të literaturës bazë dhe ndihmëse në funksion të programit të studimit si në format fizik ashtu edhe elektronik.</p> <p>Duhet theksuar se përveç Bibliotekave të Universitetit, studentët e programit “Bachelor në gjuhë italiane” kanë mundësinë të shfrytëzojnë edhe Këndin e Leximit të DGJH-së (17 vende), ku në dispozicion të studentëve ka një numër të madh tekstesh në gjuhën italiane por edhe literaturë botërore e përkthyer në gjuhën italiane, trashëgimi kjo nga Ish- Spazio Culturale. (Evidenca III.12)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>UV në funksion të mësimdhënies dhe me mbështetjen e MASR ka mundësuar siç dhe u konstatua në faqen e internetit të institucionit, por edhe nga konfirmimi nga ana e studentëve dhe personelit akademik, që IAL i ka siguruar personelit akademik dhe studentëve shërbimin e bibliotekës on-line “ULIBRARY”. Udhëzimet për përdorimin e bibliotekës online gjenden në Manualin e Përdorimit të UMVS. (Evidenca III.14). Studentët dhe personeli kanë mundësi aksesimi online në libraritë e fushave të ngjashme apo të përafërta me ato të programit të studimit.</p> <p><i>Rekomandohet</i></p> <p><i>Do ishte me vend që DGJH të mundësonte evidentimin e faktit sesa e kanë përdorur studentët por edhe stafi shërbimin e bibliotekës online, cilat kanë qenë fushat e kërkimit, tipologjia e materialeve të kërkuar, si dhe tituj për të pasur kështu një feedback të qartë në suksesin e këtij shërbimi si dhe për të matur interesin e treguar nga ana e studentëve ashtu edhe të personelit akademik të këtij programi.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në turin online të zhvilluar konstatuam ekzistencën e një laboratorit fonetike/informatike në funksion të programit të studimit. Aty mundësohet kryerja e orëve të seminareve, të laboratorit etj. (Evidenca III.12). Përveç programeve kompjuterike ekzistuese, gjithashtu DGJH ka bërë kërkesë për pajisjen e Laboratorit me software për përkthimin.</p> <p><i>Rekomandohet</i></p> <p><i>Pajisja sa më e shpejtë e nevojta e pajisjes së Laboratorit me software për përkthimin dhe blerja e një laboratorit për interpretimin.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të</p>	<p>Sistemi i menaxhimit UVMS i UV, ka të integruar edhe platformën e-</p>



mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	learning, e cila bën të mundur komunikimin e personelit akademik të UV-së me studentët për secilën prej lëndëve të planit mësimor të programit të studimit. Kjo mundësohet falë hapësirave personale të secilit përdorues të këtij sistemi, ku pedagogu i lëndës ka mundësinë të ngarkojë në sistem materiale mësimore, të caktojë detyrat, projekte, që janë të aksesueshme nga studentët e klasave përkatëse. (Evidenca III.14)			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Në Manualin e përdorimit të UMVS (Evidenca III.14), thuhet që platforma elektronike shërben edhe për të patur akses në dokumentacionin elektronik (fatura të ndryshme). Duhet theksuar se aksesin në këtë dokumentacion bëhet nëpërmjet përdorimit të hapësirës vetjake të dedikuar ose përdorimit nga adresa elektronike personale zyrtare. (emer.mbimer@univlora.edu.al)			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studenti që studion në programin “Bachelor në gjuhë italiane” bazuar në Rregulloren e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca I.4) mund të diplomohet vetëm pasi t’i ketë përmbyllur detyrimet akademike përmes provimit të formimit (Evidenca III.16) ose punimit të diplomës, në varësi të notës mesatare e cila është përcaktuar 9. Studenti bën një projekt- propozim të hartuar sipas shtojcave të Vendimit të Senatit nr 65/2016 dhe sipas Rregullore së Programit (Evidenca I.4). Sipas Rregullore, për studentët që do të diplomohen me punim diplome, pedagogu udhëheqës orienton studentin rreth metodologjisë që do të përdorë, mënyrën e hartimit të punimit dhe stilin e punimit duke respektuar rregulloren për paraqitjen dhe stilin e punimeve të diplomës e disponueshme ne faqen web . (Rregullore e DGJH <a href="https://univlora.edu.al/rregullore-e-departamentite-gjuheve-te-huaja-2/">https://univlora.edu.al/rregullore-e-departamentite-gjuheve-te-huaja-2/</a> ) <i>Rekomandohet:</i> 1. <i>Rishikimi i formulimit të diplomës që lëshohet në mbarim të studimeve për faktin që ka një mospërputhje për faktin që aty shkruhet mbrojtje e tezës së diplomës kur rregullorja parashikon në detyrimet përmbyllëse “provim i përgjithshëm apo temë diplome” gjë që nuk pasqyrohet në modelin e paraqitur të diplomës. Modeli nuk paraqet provimin të përgjithshëm. (Evidenca I.4 neni 13)</i> 2. <i>Ulje e mesatares së kërkuar për punim diplome, për të mos penalizuar ata studentë që edhe pse me mesatare më të ulët se 9 janë të aftë të hartojnë një të tillë. Mesatarja jo gjithmonë reflekton realitetin formues dhe aftësitë kërkimore. Rekomandohet mesatarja mbi 7.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b> <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	UV bazuar në vendimin “Vendimi nr. 84 i Senatit Akademik të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë për ngritjen e NJSBVCI”, (Evidenca III. 1), IAL ka ngritur këtë njësi në funksion të nxitjes së përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies si dhe Drejtorinë e



<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Edukimit për Ciklin I dhe II. Të dyja këto struktura synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Ato koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Ato përpilojnë dhe pasqyrojnë të dhënat në raportin vjetor (Evidenca J) apo edhe në raporte të tjera bazuar kryesisht në të dhëna sasiore si dhe bashkërendojnë aktivitetet për informimin e maturanëve apo sigurojnë ndërveprimin me aktorë në tregun e punës. (Evidenca I.12)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas RVB dhe DGJH është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes tek personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. Anëtarët e personelit akademik të DGJH-së, pasi njihen me raportet e anketimeve të kryera me studentët në programet që ofron njësia i diskutojnë ato dhe dalin me sugjerime, rekomandime e plan-veprime. (Evidenca III.2). Gjatë takimit me studentët, konstatoam se ata janë të përfshirë në fushatat informuese dhe promovuese për Plotësimin e Pyetësorit të Studentëve për Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies, Sondazhit Kombëtar të Studentëve, (Aneksi 1, RVB) si dhe në grupe të ndryshme të ngritura me qëllim përpilimin ose rishikimin e instrumentave të vlerësimit të brendshëm. Mendimi i tyre mbi programet dhe lëndët është një burim mjaft i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë dhe të shërbimeve akademike/ ndihmësakademi. (Aneksi 1, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>UV ka ngritur Qendrën Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC) në nivel institucional, ku një prej qëllimeve të saj është mbështetja e metodave eksperimentale bashkëkohore. Një produkt i kësaj qendre është dhe Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe novatore të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. (Evidenca N) Sipas personelit akademik, gjatë takimit të zhvilluar me ta, metodat e reja inovative të mësimdhënies janë gjithashtu pjesë e konferencave shkencore ku ata marrin pjesë. DGJH ka zhvilluar dhe mirëpritur dhe një sërë trajnimesh apo leksionesh në lidhje me metodat e reja inovatore kryesisht në kuadër projektesh apo bashkëpunimesh ndërkombëtare ( Projekti Re@WBC) (Evidenca II.13)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli Akademik i DGJH kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme (Evidenca II.12) dhe këtë e dëshmojnë edhe CV-të e stafit të angazhuar në programin e studimit ku rezulton se personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor. Gjithashtu konstatohet që numri i madh (50) i botimeve shkencore dhe konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare ku ata kanë marrë pjesë për vitet 2016-2019. Numri i aktiviteteve 2016-17 është 10 nga të cilat 6 në bashkëpunim me universitete të huaja. Numri i këtyre pjesëmarrjeve në konferenca si kumtues shkon 204 gjë që është dëshmuar i qartë i kërkimit personal për rritje profesionale të secilit anëtar të DGJH. (Aneksi 1, tab 24. RVB)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Trajnimi i stafit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja ndodh kryesisht përmes programeve të shkëmbimit dhe stafi DGJH është ai me numër më të lartë hyrjesh dhe daljesh (Aneksi 1 tab. 24 RVB) Trajnime të ndryshme kryhen edhe nga vetë stafi si pjesë e zhvillimit profesional (Evidenca II. 12) Në institucion, trajnimet janë kryer kryesisht përmes projekteve duke zbatuar modelin “trajno trajnerin”. Të tilla janë realizuar disa në kuadër</p>



	të projektit Re@WBC. (RVB)			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Të gjitha përgjegjësitë e personelit akademik dhe ndihmës akademik për zbatimin e programeve të studimeve që DGJH ofron dhe angazhimin e tyre për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja janë të parashikuara në Rregulloren e Departamentit të Gjuhëve të Huaja. (Evidenca I.2). Gjithashtu ndarja e personelit akademik në grupe mësimore, gjë që u konfirmua edhe takimin me ta (Tak 3 dita 1) ndihmon për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. (Evidenca I.8)			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Procesi i testimit të metodave të reja në mësimdhënie nga personeli akademik realizohet më tepër në bazë të iniciativave individuale, si pjesë e studimeve (Evidenca II.12) që stafet kryejnë, sidomos ata me profilin mësimdhënie e gjuhës së huaj. Këto gjetje raportohen në formën e kumtesave në aktivitetet që DGJH ka organizuar. (Aktivitete në dëpartamentine DGJH) <i>Evidentohet</i> <i>Mungesë verifikimi i një raportimi periodik mbi testimin e përdorimit të këtyre metodave të cilat nuk duhet të jenë vetëm në rang individual por edhe si grupe pune apo si DGJH.</i> <i>Sugjerohet të realizohet një i tillë për të qenë sa më koherent në testimin dhe përdorimin e tyre në terren.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në Rregulloren e Institucionit (Evidenca C). Rregulloren e Programit të Studimit (Evidenca I.4), Rregulloren e Departamentit të Gjuhëve të Huaja (Evidenca I.2) dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane (Evidenca I.6). Format e kontrollit paracaktohen nga titullari i lëndës. Ai mund të përfshijë në to kontrole të pjesshme si dhe një provim final. Gjithashtu përveç kontroleve dhe provimeve ka edhe forma të tjera vlerësimi që lidhen me detyrat, projektet, esete etj., vlerësimi zë një përqindje të caktuar të cilat konvertohen në pikë që i shtohen vlerësimit përfundimtar. Pra vlerësimi përfundimtar është një shumatore e të gjitha këtyre vlerësimeve të llojeve të ndryshme. (Evidenca II.12)
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në evidencën (Evidenca II.6) konstatohet që çdo fillimviti/semestri akademik, studentët e regjistruar në programin e studimit “Bachelor në gjuhë italiane” informohen për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Kjo bëhet më anë forma të ndryshme të komunikimit: email apo komunikime direkte (Evidenca II.6)
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore	Ashtu siç vihet re në programet lëndore të programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca II.2), testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	forma dhe mënyra të ndryshme. Këtu përfshihen vlerësimet me shkrim e me gojë për t'u dhënë mundësi studentëve të shprehin njohuritë/dijet/shprehitë në forma të ndryshme. Gjithashtu, forma të tjera të punës me studentët përfshijnë ese, punë kërkimore, projekte, që zënë 10% të vlerësimit përfundimtar. (Evidenca I.4 neni 7,8)		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Sipas Rregullores së Programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca 1.4), programi mësimor “Bachelor në gjuhë italiane” përmban vlerësim të shtrirë gjatë semestrit/viti akademik, i cili parashikon provime të pjeshme, vlerësime vjetore (në bazë të detyrave, eseve, projekteve, aktivizimit në klasë e formave të tjera të vlerësimit).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<i>Sqarim</i> Në lidhje me këtë kriter edhe pse në RVB shkruhet që UV nuk disponon një sistem të tillë duhet thënë që ai tashmë është ekzistues pasi raporti është shkruar para periudhës së pandemisë dhe gjatë kësaj periudhe platformat elektronike mësimore ku zhvillohet mësimi online i kanë automatikisht të përshira dhe zhvillimet e testeve/provimeve online dhe sistemet e vlerësimit. (kjo u konfirmua edhe në takimin e studentët (takimi 3 dita 2)
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve kryhet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. Vetëm komisioni i provimit të diplomës përbëhet prej 5 anëtarësh. Komisionet propozohen nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohen nga dekani. Komisionet e provimeve pasqyrohen në orar, i cili bëhet publik në mjedise të fakultetit/rrjete sociale të paktën dy javë përpara datës së përcaktuar për kontrollin e dijes. (Evidenca II.9)
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Mbështetur në Rregulloren e UV (Evidenca C), procesi i testimit dhe vlerësimit të dijeve, me shkrim nuk zhvillohet në mënyrë anonime ndërsa ai i administruar përmes UVMS-së garanton anonimatin dhe transparencën. Çdo pedagog hedh vlerësimet e provimeve, detyrave për çdo student në lëndën e vet përmes llogarisë së vet në UVMS dhe mund t'i konfirmojë ato vetëm pasi studenti është njohur me vlerësimin për provimin, detyrat etj. përmes llogarisë së tij/saj në UVMS, ka parë testin/detyrën e korrigjuar dhe është dakord me vlerësimin e pedagogut. Në rast konstatimi gabimi në vlerësim, pedagogu mund të ndryshojë vlerësimin në llogaritë e tij në UVMS. Procedura në lidhje me afatet e ndryshimit të rezultateve të provimit praashikohen nga Rregullorja UV (Evidenca C neni 61).
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të	Sipas Rregullores së UV (Evidenca C), pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta që të shikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigje të tyre dhe të paraqesin eventualisht konstatimet/ankesat e tyre për vlerësimin, në rast se ka të tilla. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët dhe personelin akademik, u informuam se pas realizimit të provimeve, ekzistonte hapësira për komente apo diskutime në funksion të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



përmirësohet në të ardhmen.	përmirësimi të procesit të të nxëniet.			
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Rregullorja e UV (Evidenca C, neni 82), Rregullorja e Fakultetit (Evidenca I.6, neni 51), Rregullorja e programit të studimit (Evidenca I.4), Programi lëndor (Evidenca II.2, neni 15) parashikojnë marrjen e masave përkatëse në rast plagjiature, kopjimi në provime e detyra. Kështu DGJH i shmang ato bazuar në këto dokumente.			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Programet e lëndëve (Evidenca II.2) përcaktojnë mënyrën e vlerësimit dhe peshën e të gjithë përbërësve të vlerësimit. Çdo tezë provimi i ka të përcaktuara qartë pikët për çdo rubrikë që synon kontrollin e dijeve dhe aftësive që merr studenti për rubrikë nga totali shumator. (Evidenca III. 20) Vlerësimi përfundimtar bazohet në rezultatet e provimit të pjesshëm (25-30%), detyrave të kursit apo projekteve (10-15%) dhe provimit përfundimtar (60%). Sipas Rregullores së FSHH (Evidenca I.6, neni 41) dhe programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane” (Evidenca I.4, neni 9), pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim), pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalohet deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas Rregullores së UV (Evidenca C, neni 61), studentët gëzojnë të drejtën të njihen me vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale për të gjitha format e kontrollit të dijeve të përcaktuara në syllabusin e lëndës/modulit përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare. Gjithashtu, e drejta e studentit për t’u njohur me vlerësimin dhe kërkesa për rishikim të vlerësimit garantohej nga Rregullorja e Fakultetit (Evidenca I.6, neni 41) dhe Programit të Studimit (Evidenca I.4 neni 9).			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët në UV bazuar në Rregulloren e Universitetit, Fakultetit dhe Programit të Studimit të lartëpërmendura përcaktojnë të drejtën e studentit për ankimim dhe përcaktojnë procedurën për vlerësimin e ankesës përmes ngritjes së një komisioni të posaçëm, vendimi i të cilit për vlerësimin e provimit është përfundimtar, gëzojnë të drejtën për rishikimin e fletës së provimit kur ai nuk është dakort me vlerësimin dhe ka të drejtë të kërkojë sqarimet përkatëse nga pedagogu. Në rastin kur ai sërish nuk bindet në lidhje me rezultatin gëzon të drejtën e një kërkesë ankimi me shkrim pranë sekretarisë së departamentit dhe në bazë të kësaj kërkesë ngrihet një komision ad –hoc për ta shqyrtuar atë dhe për të dhënë vlerësimin e mëpasëm përfundimtar. (Evid C, neni 61), (Evidenca I.4, neni 9).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive,	Nga shqyrtimi (Evidenca I.8) lidhur me programin e studimit “Bachelor në gjuhë italiane” rezultojnë se ky program studimi garanton thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Veprimtaritë formuese që karakterizojnë këtë program studimi ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës, etj).</p> <p>Ato grupohen në kategoritë e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë (32 kredite apo 17.7% ECTS),</li> <li>- Lëndë karakterizuese (95 kredite apo 52.7% ECTS),</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore (26 kredite apo 14.4% ECTS),</li> <li>- Lëndë plotësuese (20 kredite apo 11.1% ECTS), dhe</li> <li>- Detyrimet përmbyllëse (7 kredite apo 3.8% ECTS) (Evidenca I.8)</li> </ul> <p>Programi paraqet objektiva të caktuara për formimin e studentëve ku bëjnë pjesë jo vetëm formimi gjuhësor i tyre por edhe aftësimi profesional dhe kulturor që karakterizojnë programin. (Evidenca I.4)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Bazuar (Evidenca I.4, neni 3), (Evidenca I.8) lidhur me Rregulloren e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane”, programi i studimit “Bachelor në gjuhë italiane” duket qartë që ai garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit kështu studime të komunikimit (për të cilën është sygjerasar ndryshimi i emërtimit), kurse të gjuhës ndër të cilat mund të zgjedhin kurset në anglisht, frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, të përfshira në kategoritë e lëndëve integruese dhe plotësuese (Evidenca I.4, neni 3), (Aneksi 1, tab.9).</p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	<p>DGJH çdo fillim viti akademik analizon punën e bërë me studentët, duke marrë në shqyrtim rezultatet e arritura si dhe vlerësimet e tyre të marra nga pyetësorët (Raporti i analizës vjetore, faqja Web ) dhe sipas rastit reflektohen ndryshime në kurrikul apo bëhen përditësime të programeve të programit lëndor në tema apo literaturë (Evidenca II.8), kjo për t’iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të studentëve si dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe për të arritur objektivat në lidhje me arritjen e kompetencave dhe aftësive të studentëve.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	<p>Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. Këto çështje analizohen edhe në analizën vjetore të punës në departament të DGJH (Evidenca I.22).</p>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Organizimi i orëve të hapura për studentët të cilët ndjekin programin e studimit “Bachelor në gjuhë italiane” mundësohet në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti, duke ftuar ekspertë të fushës, vendas apo të huaj për të organizuar seminare, ëorkshop, leksione dhe për të diskutuar mbi zhvillimet e reja të shkencës jashtë strukturës së programit të studimit. (Evidenca III.9 dhe II.13).</p>
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	<p>Bazuar tek (Evidenca II.2) lidhur me Programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane” konstatohet që mësimdhënia tek lëndët e planit mësimor për programin e studimit realizohet prej stafit akademik mbi bazë kompetencash të parashikuara në kurrikulën e programit të studimit në fjalë, në mënyrë të veçantë tek lëndët karakterizuese të cilat u japin studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë shkencore – profesionale.</p> <p>Në takimet e zhvilluara u përforcua fakti që lëndë si teknika të përkthimit, fonologji dhe gjuhë italiane zhvillohen kryesisht në laboratorë.</p>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik	Stafi akademik i këtij programi studimi mbështet diskutimet dhe punë



mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	në grup të studentëve dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke krijuar kushtet dhe favorizuar organizimin e punës në grup gjatë orëve të seminareve dhe studimit individual. Kjo përcaktohet edhe edhe në programin lëndor (Evidenca II.2), nëpërmjet detyrave që u jepen studentëve për vlerësimin vjetor por rezultojnë edhe nga anketimi i studentëve.		
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	DGJH krijon një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve gjë që na u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët. Kjo konstatohet gjithashtu edhe në organizimin e konferencave studentore dhe shkollave verore (Aktivitete Departamenti Web ), publikimi të thirrjeve të aktiviteteve për studentë brenda dhe jashtë Shqipërisë (Faqja FCB e Departamentit) përfshirjen e studentëve në aktivitete shkencore të organizuara nga vetë personeli akademik, etj. (Konferenca e IV ndërkombëtare faqja Web )		
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	IAL ka mbështetur financiarisht organizimin e konferencave studentore. (Evidenca III.21). Kjo gjë u konfirmua edhe nga takimet e kryera gjatë vizitave online.		
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik i Departamentit të Gjuhëve të Huaja merr pjesë gjerësisht në aktivitete ndërkombëtare dhe ka numrin më të madh të bashkëpunimeve në rang institucioni (Marrëveshje Ndër-Institucionale, Web), sidomos për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve, kryesisht përmes programit ERASMUS +, komponenti KA 107 ICM që prej vitit 2016, por edhe të tjera si CEEPUS (Evidenca I. 16). Format e mësimdhënies të aplikuara prej stafit akademik në DGJH janë pothuajse në harmoni dhe ndjekin format e mësimdhënies të institucioneve evropiane me të cilët DGJH/UV ka bashkëpunime çka synon të lehtësojë procesin e mobilitetit të studentëve dhe kjo vërtetohet nga numri në rritje i mobiliteteve të realizuara (Statistika Web , Aneksi 1).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Provimi final ose mbrojtja e diplomës para diplomimit të studentëve për studentët e Ciklit të parë “Bachelor realizohet sipas procedurës në përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit (Evidenca I. 4, neni 13) dhe kjo procedurë bëhet publike dhe u prezantohet studentëve gjatë takimit informues në lidhje me procesin e diplomimit që realizohet për studentët e vitit të fundit prej përgjegjësit të departamentit dhe sekretarisë mësimore.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së	Procedura për realizimin e provimit final është e përcaktuar qartë në Rregulloren e programit të studimit (Evidenca I.4, neni 13). Sekretaria mësimore dhe personeli akademik asistojnë studentët duke u dhënë sqarime mbi modalitetet për dhënien e provimit final. Provimi final ka programin e vet, i cili përcakton mënyrën e dhënies së këtij provimi, njohuritë dhe aftësitë që teston, përmbajtjen lëndore sipas disiplinave të përfshira në provimin e formimit (Evidenca III.20). Programi është i

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



diplomës.	<p>disponueshëm online dhe u njoftohet dhe shpërndahet studentëve përmes sekretarisë mësimore, por edhe faqes Web .  <a href="https://:univlori.edu.al/studentet-e-departmentit-te-gjuheve-te-huaja/">https://:univlori.edu.al/studentet-e-departmentit-te-gjuheve-te-huaja/</a></p> <p>Ndërkohë, pedagogët udhëzojnë studentët në lidhje me materialet, pyetjet dhe përmbajtjen e disiplinave që japin që janë të përfshira në provimin e formimit.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p>Procedura e provimit përfshin një provim me shkrim dhe një me gojë Sipas Rregullores së Programit të Studimit “Bachelor në gjuhë italiane (Evidenca I.4, neni 13). Komisioni përbëhet më së paku nga 5 anëtarë që mbulojnë disiplina (Evidenca III. 16), Programi është i disponueshëm online dhe u bëhet me dije nga sekretaria mësimore dhe faqja FCB e DGJH.</p> <p>Provimi i formimit bazohet në testimin e njohuritë e dhëna në lëndët bazë të rëndësishme dhe ato karakterizuese e ndërdisiplinore gjatë tri viteve akademike.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	<p>Personeli akademik i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, i cili ka hartuar bankën e pyetjeve dhe programin e provimit të formimit dhe/ose që udhëheq studentët për përgatitjen e temave të studimit/diplomave, orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave duke komunikuar me ta nëpërmjet postës elektronike ose kontaktit të drejtpërdrejtë. (Evidenca I.2)</p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>Studentët të cilët janë duke punuar temën e diplomës kanë mundësinë të shfrytëzojnë bazën e të dhënave të institucioneve të tjera, me të cilat universiteti ose fakulteti bashkëpunon për realizimin e praktikave të studentëve (Aneksi 1, tab 5), software për kryerjen e analizave statistikore në gjuhësi për përdorimin e të cilave udhëzohet nga pedagogu i fushës, si dhe asiston studentët për kryerjen e kërkimit në lidhje me temën në laboratorin e DGJH-së.</p>
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	<p>Udhëheqësi i temës miratohet nga komisioni i posaçëm i bazuar mbi kompetencën e fushës, pikërisht me qëllimin për të asistuar, kontrolluar dhe vlerësuar punimin e studentit. Ai sigurohet që studentit të ndjekë të gjitha rregullat për hartimin e temës në zbatim të Rregullores (Evidenca II.14) e cila është e disponueshme online. Ai udhëzon studentin të ndjekë formate të gatshme të cilat janë pjesë e kësaj rregulloreje.</p> <p>Ai garanton cilësinë e punimit nëpërmjet miratimit me shkrim dhe vlerësimit me shkrim para komisionit (Evidenca II 14, Shtojca 4 Vendimi SA nr. 65/2016)</p>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	<p>Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë. Rregullorja e Programit të Studimit “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca I.4, neni 13) përcakton mënyrën e vlerësimit në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, ku studentët që kanë prezantim diplome në përfundim të mbrojtjes vlerësohet nga komisioni i cili bazohet në vlerësimin recensues të punimit dhe jep një vlerësim kolegjal të studentit me notë.</p>
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	<p>Në përfundim të studimeve, studentit pasi ka plotësuar detyrimet e programit të studimit dhe çdo detyrim financiar dhe material kundrejt IAL pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, (Evidenca I.4, neni 14) .</p>
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare	<p>Në përfundim të studimeve, studentët që kanë përfunduar Programin e plotë të studimit u vihet në dispozicion një listë notash dhe suplementi i diplomës. Programi i plotë i studimit i vihet në dispozicion me</p>



e programit të studimit të zhvilluar.	kërkesë të tij. Statuti i UV (Evidenca A, neni 71) përcakton qartë mënyrën e lëshimit të diplomave, certifikatave dhe suplementit të diplomës.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sekretaritetë mësimore (Evidenca C neni 54, Tak dita 6 dita 1) mbajnë një regjistër themeltar ku shënohen të dhëna për arritjet akademike, lëshimin e diplomave me të dhënat e tyre personale, vlerësimet e marra, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e formatuara këto sipas standardeve shtetërore. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pastër, pa korrigjime dhe ku nuk lejohen ndryshime për asnjë lloj arsyeje. Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X






**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Sipas RVB dhe deklarimeve nga autoritetet drejtuese të Fakultetit gjatë takimeve të zhvilluara, përgjegjësia për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit është kompetencë e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, pjesë e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Ndërkohë, Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik ruan dosjet e personelit akademik me arritjet dhe aktivitetin akademik e shkencor të tyre. Në statutin dhe rregulloren e përgjithshme të UV-së si dhe në kontratën e punës së personelit të angazhuar janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me funksionin përkatës të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në përputhje me <i>nenin 29</i> të Rregullores së UV-së e ndryshuar (Evidenca C) dhe Statutin e Universitetit të Vlorës (Evidenca A), rekrutimi i personelit akademik bëhet me kërkesën e njësisë bazë dhe kryesore sipas nevojave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, kërkesë e cila përcillet në rektorat. Pas vlerësimit të kërkesës, duke iu referuar edhe numrit të përgjithshëm të personelit në të gjitha nivelet sipas vendimit të miratuar nga Bordi i Administrimit, është Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Burimeve njerëzore i kësaj drejtorie, që harton dhe ndjek procedurat për rekrutimin e personelit akademik që nga njoftimi për shpalljen publike të vendit të lirë në këndin “Njoftime punësimi” në faqen zyrtare Web të Universitetit dhe deri në përfundim të procesit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Sipas RVB dhe konfirmimit në takimet me autoritetet drejtuese të Fakultetit dhe përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore, procedura dhe kriteret e posaçme për rekrutimin e personelit përcaktohen në <i>nenet 51 dhe 52</i> të Statutit të UV-së, (Evidenca A) si dhe në <i>nenet 28 dhe 29</i> të Rregullores së UV-së e ndryshuar (Evidenca C).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	<p>Kriteret e përgjithshme për punësim janë të përcaktuara në <i>nenin 28</i> të Rregullores së UV-së (Evidenca C), ndërsa kriteret specifike për rekrutimin e personelit hartohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e saj. Në fillim të çdo viti akademik Departamenti i Gjuhëve të Huaja përcakton ngarkesën e pedagogëve në përputhje me nevojat e realizimit të programeve të studimit (Evidenca I. 8). Pas shpërndarjes së ngarkesës, përcaktohen dhe nevojat për personel të ri akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, si dhe kriteret specifike me qëllim përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit profesional</p>







<p>strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Kërkesa bashkë me kriteret e përgjithshme dhe specifike i përcillet Dekanit e më pas Rektorit, i cili bën miratimin e tyre dhe urdhëron shpalljen publike të kriterëve në njoftimin përkatës për punësim. Për vlerësimin e kandidatëve aplikantë, Rektori urdhëron ngritjen e komisionit <i>ad hoc</i> të përbërë nga 5 anëtarë, 3 nga të cilët nga njësia bazë përkatëse, 1 përfaqësues i dekanit, dhe 1 përfaqësues i rektorit.</p> <p>Konkurimi zhvillohet në dy faza. Faza e parë <i>konkurimi me dosje</i> dhe më pas <i>intervista</i>. Komisioni pas vlerësimit të kandidatëve për të dyja fazat e konkurimit, bën renditjen përfundimtare të tyre sipas pikëve të grumbulluara. Këto rezultate bashkë me gjithë dokumentacionin përkatës përcillen nëpërmjet dekanit për në Rektorat, ku Rektori vendos përfundimisht mbi çdo kandidaturë.</p> <p>Në bazë të <i>nenin 27</i> të Rregullores së UV-së për një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv konkurentëve u garantohet gjithashtu edhe e drejta e ankimit të Rektori brenda 5 ditëve si në përfundim të fazës së parë të vlerësimit, ashtu edhe në përfundim të fazës së dytë.</p> <p>Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizmin ose ndryshimin e vendimit të komisionit <i>ad hoc</i> në çdo fazë të konkurimit.</p> <p>Në përfundim të të gjithë procedurës, pas përfundimit edhe të afatit të ankimit, Rektori bën shpalljen e fituesve, emërimin e tyre, hartimin e kontratës së punës dhe nënshkrimin e saj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës virtuale dhe shqyrtimi i dokumentacionit mbi Infrastrukturën e FSHH-së (Evidenca III.11), rezulton se ekziston infrastruktura e duhur për krijimin e një mjedisi dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Të gjitha ambientet (klasat, bibliotekat, laboratorët, zyrat e personelit akademik dhe jo akademik) kanë kushtet e duhura strukturore dhe higjeno-sanitare për studentët dhe personelin. Me një sipërfaqe prej 3040 m<sup>2</sup> Godina B ku zhvillon aktivitetin edhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja plotëson parametrat për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme pedagogjike dhe kulturore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e</p>	<p>Siç evidentohet edhe nga Strategjia për Trajnimin e vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj (Evidenca G), apo edhe nga <i>neni 4</i> i Statutit të UV-së, institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik që mbulon dhe administron programin e studimit. Edhe Strategjia e Ndërkombëtarizimit të Universitetit 2016-2020 është hartuar në funksion të këtij angazhimi. Nga biseda me anëtarët e Departamentit të Gjuhëve të Huaja u evidentua ekzistenca e një sërë marrëveshjeve bashkëpunimi (Evidenca I.24) në kuadër të programit Erasmus+, si edhe e mobiliteteve të kryera në kuadër të këtyre marrëveshjeve nga shumë prej anëtarëve të departamentit. Angazhimi i institucionit në drejtim të kualifikimit të personelit tregohet edhe nëpërmjet mbështetjes financiare të siguruar nga institucioni për aktivitetet shkencore të stafin akademik. Kjo mund të evidentohet nga dokumentet shoqëruese (Evidenca IV.3) ku vihet re se në kërkesën e Departamentit të Gjuhëve të Huaja drejtuar administratorit të UV-së për fondet e parashikuara të shpenzohen gjatë vitit 2019-2020, janë parashikuar si zëra të veçantë: <i>Kostot e trajnimit dhe seminareve, Shpenzime për organizimin e konferencave, Shpenzime për aktivitetet social kulturore, si dhe Shpenzime për kërkimin shkencor në formën e librave dhe publikimeve profesionale.</i> Nga biseda me anëtarët e departamentit gjatë takimit online, u konstatua se të gjitha këto aktivitete të parashikuara ishin zhvilluar dhe u konstatua, gjithashtu, se disa prej pedagogëve, ndër vite, kishin patur mundësi të mbështeteshin financiarisht nga UV-ja për pjesëmarrje në konferenca të zhvilluara jashtë shtetit apo edhe për botim artikujsh shkencorë. Kjo mbështetje për aktivitete shkencore individuale të stafit akademik mund të verifikohet edhe në dokumentet zyrtare shoqëruese (Evidenca III.7).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik edhe pse është miratuar me vendimin e Rektoratit të datës 13.01.2020 “<i>Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit</i>” (Evidenca N) nga RVB deklarohet se UV-ja ende nuk organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja.</p> <p><i>Këshillohet organizimi i trajnimeve për stafin akademik me qëllim që pedagogët të jenë gjithmonë të përditësuar me metodat inovative të mësimdhënies edhe në funksion të sigurimit të cilësisë në mësimdhënien e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas RVB dhe deklarimeve të bëra në takimet online me autoritetet drejtuese të fakultetit, institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. Organizmi i punës, si dhe ndarja optimale e ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore shkencore sipas kompetencave profesionale të secilit pedagog planifikohet dhe mbikqyret nga ana e Departamentit (Evidenca II.11).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e**



**përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës virtuale dhe shqyrtimi i dokumenteve shoqëruese në lidhje me Infrastrukturën e FSHH-së (Evidenca III.11), rezulton se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane”. Edhe sipërfaqja e ambienteve në dispozicion të studentëve (2.8 m<sup>2</sup>/student ) dhe në dispozicion të stafit (10.3 m<sup>2</sup>/person) siç rezulton nga tabela 16 (Aneks – Tabelat përmbledhëse) gjykojmë se janë më se të mjaftueshme për zhvillimin sa më mirë të veprimtarive mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita virtuale në ambientet e institucionit rezulton se ky kriter përmbushet pasi mjediset mësimore si: klasa, laboratorë, këndi i leximit e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Departamenti ka në përdorim dy videoprojektorë dhe Këndi i Leximit ka, përveç dy kompjuterave, edhe një fotokopje që lehtëson punën për shumëfishimin e materialeve që mund të nevojiten gjatë procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës virtuale të realizuar, u konstatua se Departamenti i Gjuhëve të Huaja disponon dy laboratorë. Një laborator në katin e tretë (B 302) i cili përmban mjete teknologjike (kompjuter, sinjal interneti, programet bazë, kufje, kamera, videoprojektorë), si dhe mjetet e nevojshme të përshtatshme për zhvillimin e orëve teorike dhe praktike kryesisht në lëndë si: <i>fonetika, përkthimi</i> etj., bazuar në objektivat e programeve mësimore. Laboratori i vendosur në katin e katërt (B 402), i konceptuar si sallë për praktikë mësimore, ku studentët mund të kryejnë prezantimin e punimeve të ndryshme duke përdorur videoprojektorin dhe programe të ndryshme si poëer-point, është përshtatur për zhvillimin e orëve mësimore me karakter didaktik, paraqitjen e punëve/detyrave në module të caktuara, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Siç shprehet edhe grupi i punës i vlerësimit të brendshëm në raportin e tij, por edhe siç u konstatua gjatë vizitës virtuale, laboratori i teknologjisë së informacionit (B 302), i konceptuar kryesisht për zhvillimin e moduleve të tilla si: <i>Gjuhë e Huaj, Qytetërim, Fonetikë, Kërkim-Shkencor, Histori</i>, përdoret edhe për zhvillimin e lëndës së Përkthimit. Por, pavarësisht se janë instaluar programet bazë, mungojnë softet specifike-profesionale (TRADOS apo ndonjë tjetër) për lëndën e Përkthimit. Vihet re, gjithashtu, mungesa e një laboratorit të përshtatshëm për zhvillimin e lëndës së Interpretimit.</p> <p><i>Këshillohet pajisja e laboratorit ekzistues me software specifike për përkthimin, si edhe blerja e një laboratorit të ri të përshtatshëm për zhvillimin e lëndës së interpretimit (me së paku dy kabina për interpretimin simultan), gjë që do të kishte efekt pozitiv në realizimin e programit të studimit dhe përforcimin dhe zbatimin e njohurive</i></p>



	<i>praktike në fushën e përkthimit dhe interpretimit.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Studentët e gjuhëve të huaja e zhvillojnë praktikën profesionale (Evidenca I.26) gjatë studimeve në ciklin e dytë “Master”, në bazë të profilizimeve që marrin, <i>Mësuesi</i> ose <i>Përkthim</i> , në sajë të marrëveshjeve që ka UV/FSHH (Evidenca I.23). Veprimtaritë e tjera praktike mësimore që realizohen gjatë tre viteve akademike mbulohen tërësisht me kapacitetet e logjistikën e vendosur në dispozicion (laborator, biblioteka, kënd-leximi dhe auditor) nga vetë departamenti, mjedise që vlerësohen të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e tyre. (RVB)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në dispozicion të studentëve, që ndjekin programin e studimit “Bachelor në gjuhë italiane” janë 3 biblioteka, me të cilat u njohëm gjatë vizitës virtuale. Gjithashtu, studentët mund të shfrytëzojnë edhe Këndin e Leximit, i cili është i pajisur me libra që janë në funksion të programit të studimit, ndonëse fondi është më i kufizuar. Si në biblioteka, ashtu edhe në Këndin e Leximit ka personel jo akademik që mund t’i ndihmojë studentët me materialet që u nevojiten.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita virtuale e zhvilluar në bibliotekat në dispozicion të studentëve, si edhe nga shqyrtimi i Informacionit për Sektorin e Bibliotekës Shkencore (Evidenca III.15), rezulton se biblioteka u ofron studentëve mundësinë e shfrytëzimit të literaturës bazë dhe ndihmëse në funksion të programit të studimit. Duhet theksuar se përveç Bibliotekës së Universitetit, studentët e programit “Bachelor në gjuhë italiane” kanë mundësinë të shfrytëzojnë edhe Këndin e Leximit të DGJH-së, ku në dispozicion të studentëve ka një numër tekstesh në gjuhën italiane. Nga takimi i zhvilluar me punonjësin e bibliotekës u informuam lidhur me numrin e teksteve dhe materialeve të ndryshme që mund të shfrytëzohen nga studentët që ndjekin programin e studimit. Në Evidencën III.15 janë sjellë: informacione të detajuara lidhur me fondet që disponon secila bibliotekë, prejardhjen e tyre, numrin e specialistëve që punojnë në biblioteka, oraret e leximit, si edhe Rregullorja e Brendshme e Sektorit të Bibliotekës Shkencore.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Siç konstatohet në faqen e internetit të institucionit, por edhe nga konfirmimi nga ana e studentëve dhe e personelit akademik, institucioni ka siguruar për personelin akademik dhe studentët shërbimin e bibliotekës on-line “ULIBRARY”. Kohëzgjatja e përdorimit të bibliotekës online është e pakufizuar dhe mundësohet nga Qeveria Shqiptare. Siç u informuam nga studentët gjatë takimit të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	zhvilluar, ata kanë dijëni të plotë mbi mundësinë e shfrytëzimit tërësisht pa pagesë të bibliotekave si ato fizike, ashtu edhe ato online. Informacione më të hollësishme mbi përdorimin e bibliotekës online gjenden në Manualin e Përdorimit të UMVS (Evidenca III.14) Gjithashtu, në softin Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës përditësohen tekstet dhe artikujt shkencorë si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis. Net.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga vizita virtuale e zhvilluar u konstatua se të 3 bibliotekat janë të pajisura me programe kompjuterike dhe pajisje teknike duke mundësuar shfrytëzimin pa kufizime nga ana e studentëve.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Siç shihet edhe në dokumentet shoqëruese (Evidenca IV.3) në lidhje me Kërkesat buxhetore të DGJH (kërkesa për fond bibliotekë), UV u kërkon njësitëve bazë hartimin e draft/buxhetit me nevojat për pasurimin e fondit të bibliotekave pas hartimit dhe listimit të nevojshëm të librave për literaturën e duhur bashkëkohore sipas specifikimeve teknike dhe kërkesës së studentëve në përputhje me programet e studimeve të përcaktuara. Gjatë takimit virtual me punonjësin e bibliotekës u informuam se realizohet përditësim i vazhdueshëm i fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga takimi i zhvilluar me studentët dhe me punonjësin e bibliotekës u konstatua se bibliotekat janë në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Kështu, Biblioteka Qendore është e hapur: e hënë - e premte, ora 08:00-20:00. Dy bibliotekat e tjera janë të hapura gjatë orarit zyrtar 08:00-16:00. Për të llogaritur numrin e përdoruesve të Bibliotekës dhe koeficientin e shfrytëzueshmërisë përdoren statistikat vjetore, mujore dhe ditore, të cilat plotësohen sipas udhëzimeve që ka biblioteka dhe ruhen në arkiv, sipas kriterëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre	Nga takimi i zhvilluar me sekretarinë mësimore u konstatua se, ashtu siç është konfirmuar në RVB, Universiteti "Ismail Qemali" mban në formë të shkruar: 1) regjistrin themeltar të studentëve; 2) regjistrin e arritjeve akademike ku hyn dhe procesverbalin e çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik; 3) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	çertifikatave. Duhet theksuar se në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe Rregullores së FSHH, sekretaria është struktura përgjegjëse për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me arrijet akademike deri në diplomimin e studentëve. Megjithatë, krahas sekretarisë mësimore, në ndihmë të këtij procesi në UV funksionon dhe Sistemi kompjuterik UVMS, i cili u ofron mundësi veçanërisht studentëve që të kenë, në çdo kohë, një pasqyrë të qartë lidhur me ofertën akademike, administrative, sociale, kulturore e sportive të UV, brenda dhe jashtë procesit mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Siç pranohet edhe nga vetë institucioni (RVB), administrimi i informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të përfshirë në realizimin e programit ende nuk është pjesë e platformës së UVMS, por strukturat përgjegjëse për administrimin e këtij informacioni e ruajnë këtë informacion në tabela excel/ëord dhe e vënë në dispozicion sipas kërkesave për shfrytëzimin e këtij materiali. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-arkivës disponon dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Siç na u konfirmua në takimin e zhvilluar me Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, platforma UVMS, në përdorim prej vitit 2008 (Evidenca III.14) siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar dhe, më pas, secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Nëpërmjet këtij sistemi, pedagogu dhe/ose personeli ndihmës akademik akseson dokumente të tipit procesverbale me rezultatet e studentëve sipas llojit të detyrës. Ndërkohë, studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që duhet të frekuentojnë, vlerësimet dhe çdo formë kontrolli në çdo lëndë etj.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sipas asaj çka është paraqitur në RVB dhe që u konfirmua edhe në takimin virtual me stafin akademik dhe studentët, sistemi kompjuterik UVMS ofron mundësi komunikimi interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe studentëve. Pedagogët u komunikojnë studentëve nëpërmjet këtij sistemi, njoftime të ndryshme, literaturë, leksione si dhe vlerësimet për të gjitha format e kontrollit. Studentët, nëpërmjet UVMS vlerësojnë në mënyrë krejt anonime cilësinë e leksioneve, seminareve, metodave të mësimdhënies, komunikimit të pedagogëve etj. Personeli ndihmës akademik (Sekretaria Mësimore) nëpërmjet UVMS akseson vërtetime të ndryshme, procesverbale notash, shlyerje detyrimesh etj.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Siç është paraqitur në RVB dhe që u konfirmua gjatë vizitës virtuale sistemi kompjuterik UVMS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit ( <a href="https://univlora.edu.al/">https://univlora.edu.al/</a> ) të institucionit dhe nga sa u konfirmua edhe nga përfaqësues të Sektorit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun gjatë takimeve virtuale, rezulton se informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e






ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	internetit të UV-së. Informacioni jepet në gjuhën shqipe dhe atë angleze.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen</p> <p>financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë harton një raport financiar të institucionit, si pjesë e raportit vjetor (Evidencat I, J). Ai fillon me planifikimin e Njësive Bazë dhe deri në miratimin përfundimtar nga ana e Senatit Akademik dhe e Bordit të Administrimit. Megjithatë, Institucioni nuk harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi, por harton një kosto mesatare studenti në nivel universiteti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja harton një plan financiar buxhetor të përbashkët për programet e studimit që mbulon, i cili përcillet për t'u integruar në planin financiar të njësisë/institucionit dhe si rregull përmban: financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit (orë mësimore shtesë, kosto trajnimi, udhëtimi, kërkim shkencor); shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor; shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës; shpenzime të tjera kapitale për laboratorë; fonde për aktivitete shkencore etj. me preventivat përkatës. (Evidenca IV.3).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera</p>	<p>UV ka ngritur në strukturën e tij Njësinë e Auditimit të Brendshëm (Evidenca I.17). Kjo njësi është në varësi dyfishë nga Senati dhe Bordi i Administrimit. UV kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar, i cili realizohet në mënyrë periodike, përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare. Ky raport i paraqitet Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit nga Administratori i Universitetit.</p>



financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.									
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Dokumenti i analizës financiare të bërë prej universitetit në fund të çdo viti, miratohet e më pas protokollohet e ruhet në arkivën e vetë universitetit në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë-protokollin. Analiza ka edhe natyrë krahasuese për shumicën e zërave të buxhetit me periudhat ushtrimore të kaluara, me qëllim që të krijohet mundësia për të gjykuar mbi raportet financiare të viteve të mëparshme akademike dhe të planifikohen ndërhyrje të posaçme për diversifikimin e financimit të secilit program studimi për të garantuar mbarëvajtjen normale të tij. (RVB)								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Në takimet e zhvilluara online me autoritetet drejtuese të institucionit, na u konfirmua se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë i siguron burimet e financimi nga granti që akordohet nga MASR dhe Fondet e vetë institucionit të cilat sigurohen nga tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit etj. Vetë Departamenti mendon të ofrojë në të ardhmen shërbime për të tretë si: kurse gjuhësh të huaja, përkthime etj. për të siguruar të ardhura të tjera shtesë.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të siguruar nga institucioni (RVB) dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit, u konstatua se Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Programi "Bachelor në gjuhë italiane" ofrohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë nr. 80/2015 dhe aktet e tjera në fuqi (VKM nr. 41, datë 24.01.2018). Pranimi i studentëve në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>programin “Bachelor në gjuhë italiane” bëhet në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimet përkatëse të MASR përpara çdo viti akademik dhe sipas kuotave dhe kriterëve të posaçme të propozuara nga njësia kryesore (Evidenca II.1).</p> <p>Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë së Fakultetit brenda afateve të përcaktuara nga MASR. Për tarifën e shkollimit UV ndjek politika lehtësuese duke aplikuar pagesën me këste me vendime të posaçme të Bordit të Administrimit. Çdo student pajiset me adresën elektronike institucionale, e mundësuar kjo përmes sistemit informativ UVMS (Evidenca III.14), përmes të cilit studentët me anën e një kodi identifikimi që i shoqëron gjatë të gjithë eksperiencës universitare, mund të kontrollojnë studimet e tyre.</p> <p>Informacionet në lidhje me rregulloren e programit të studimit (Evidenca I.4), provimin përfundimtar, rregulloren për paraqitjen dhe stilin e punimeve janë të disponueshme në faqen Web të DGJH.</p> <p>Diplomimi kryhet me provim përfundimtar (Evidenca III.16) ose me punim diplome (Evidenca II.15) përgatitja dhe paraqitja e të cilit bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuara nga MASR.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ashtu siç parashikohet edhe në Rregulloren e Departamentit të Gjuhëve të Huaja (Evidenca I.2), politika e pranimeve në departament dhe procedurat e zbatuara prej kësaj njësie nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane”. Studimet në këtë program studimi mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët nga trojet, romë dhe ballkano-egjiptianë, persona me status të caktuar (aftësi ndryshe, jetimë), si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DGJH, të miratuara nga Senati i UV-së dhe të bëra publike përmes mjeteve të informimit zyrtar (faqja zyrtare e UV-së), fletëpalosjeve (Evidenca II.5) dhe faqeve në rrjetet sociale të UV-së.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë në përputhje me përcaktimet në Statutin e UV-së (Evidenca A) dhe Rregulloren e UV-së (Evidenca C), janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të universitetit dhe janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Siç mund të shihet në dokumentin lidhur me kuotat dhe kriteret e pranimit për programin “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca II.1), institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen nga njësia bazë në përputhje me nenin 25, pika 8 në ligjin nr.80/2015, VKM-në e posaçme (Nr. 295, datë 10.05.2019) për kriterin e mesatares në hyrje të studentëve në ciklin e parë të studimeve, dhe miratohen nga Senati Akademik i Universitetit. Kuotat e pranimit të studentëve në këtë program studimi, të propozuara nga DGJH parashikojnë kuota për</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	regjistrimin e studentëve të huaj (Evidenca II.1).		
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Siç shprehet në RVB dhe siç na u konfirmua në takimin e zhvilluar me studentët dhe Drejtorinë e Edukimit të Ciklit I dhe II, përpara periudhës së plotësisimit të formularëve të aplikimit të maturantëve, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë, përmes Drejtorisë së Edukimit të Ciklit I dhe II, Sektorit të Këshillimit dhe Karrierës, Alumni-t në bashkëpunim me njësitë bazë/kryesore të UV-së organizon takime me maturantë dhe vizita në mjediset e gjimnazeve të Qarkut Vlorë (Evidenca III.18), e më gjerë, si dhe takime pranë Qendrave Rinore të qyteteve të ndryshme për të informuar të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofrohen nga UV, duke shpërndarë broshura informative (Evidenca II.5) dhe dhënë informacion të detajuar për çdo program studimi.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin kryesisht nëpërmjet: rregullores së programit të studimit (Evidenca I.4), e disponueshme edhe online në faqen web të DGJH-së; sekretarisë mësimore; koordinorit për marrëdhëniet me studentin (Evidenca II.3); stendës së DGJH në katin e katërt të godinës B; sistemit UVMS (Evidenca III.14) i cili u ofron studentëve akses të plotë mbi përparimin e tyre akademik dhe kalimin nga njëri vit në tjetrin. Programi i studimit u prezantohet studentëve në ditën e parë të shkollës (Evidenca V.2) dhe është i disponueshëm edhe online në faqen web të DGJH-së.</p> <p>Çdo fillim viti akademik studentëve u vihet në dispozicion informacion i detajuar në lidhje me datat e fillimit të mësimit (Evidenca II.8), orarin mësimor (Evidenca IV.5), provimet e pjesshme, sezonin e provimeve (Evidenca III.19).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në takimin e zhvilluar me studentët, u konstatua se ata informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Universiteti siguron mundësinë e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UV-së.</p> <p>Procedura e njohjes (Evidenca II.9) kryhet nga Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit për transferim, për regjistrim në program të dytë studimi dhe për riparime, i ngritur pranë DGJH-së.</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit “Bachelor në gjuhë italiane” që në fillim të vitit akademik. Studentët njihen gjithashtu edhe me rregulloren e programit studimor (Evidenca I.4), e cila parashikon procedurat e vlerësimit, ndërsa kriteret e vlerësimit të dijeve përcaktohen në programin lëndor (Evidenca II.2) të çdo lënde dhe moduli prezantohet nga pedagogu i lëndës në auditor ose përmes formave të tjera të komunikimit (Evidenca II.6).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e Programit të Studimit në nenin 13 të saj (Evidenca I.4) përcakton kushtet që një student të diplomohet, si dhe mënyrën e diplomimit me provim përfundimtar ose me punim diplome. Që një student të diplomohet me punim diplome duhet të përmbushë kriterin e mesatares, i vendosur me vendim të Senatit Akademik dhe të ndjekë e përmbushë udhëzimet për punimin e diplomës (Evidenca II.15). Në rast të diplomimit me provim studenti duhet të përgatisë programin e provimit të formimit (Evidenca III.16), i cili shpërndahet nga sekretaria mësimore ose aksesohet online në faqen e departamentit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Fletëpalosja dhe guida e studentit (Evidenca II.4) është një udhëzues i posaçëm për studentët, i cili përditësohet çdo vit. Ai u shërben jo vetëm studentëve, por edhe maturantëve të interesuar për këtë program studimi. Gjithashtu, organizohen nga institucioni takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit (Evidenca III.18). Mund të përmenden këtu: open day, ëelcome day, takimet për këshillim karriere, etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><del>Nuk përmbushet</del></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca I.4), me të cilën studentët njihen që në fillim të programit të studimit. Gjithashtu, informacione marrin studentët edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore, koordinatorit për marrëdhëniet me studentin, specialistit për shërbim ndaj studentëve (i Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I dhe të II), sistemit UVMS etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët,</p>	<p>Fletëpalosja dhe guida e studentit (Evidenca II.4) është një udhëzues i posaçëm për studentët, i cili përditësohet çdo vit. Informacion për studentët gjendet edhe në rregulloren e programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane” (Evidenca I.4.) Në takimin e zhvilluar me studentët, ata konfirmuan gjithashtu se informohen përmes faqes zyrtare të universitetit dhe rrjeteve sociale. Ndërkohë, në ditën e parë të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	zhvillimit të lëndës, studentët informohen gjithashtu për elementët e ndryshëm të organizimit të lëndës, përfshirë temat që do trajtohen, mënyrën e vlerësimit, etj.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Siç tregohet edhe nga Relacioni mbi pjesëmarrjen në “Panairin e Punës 2019” (Evidenca I.11), institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt karrierës dhe tregut të punës. Ndërkohë, Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive u shërben studentëve të UV-së si urë lidhëse me tregun e punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. <i>Pavarësisht këtyre angazhimeve është e nevojshme të bëhet akoma edhe më shumë për mbështetjen institucionale të studentëve dhe për orientim edhe më të mirë drejt tregut të punës.</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët informohen lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij përmes faqes së internetit të institucionit, sistemit informativ UVMS, sekretarisë mësimore të DGJH-së, programit të orientimit në ditën e parë të shkollës (për studentët e vitit të parë) (Evidenca V.2), si dhe stendës me informacionet e përditësuara, e cila gjendet në katin e katert, Godina B.								
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Ashtu siç shprehet në RVB, gjë që u konfirmua edhe në takimin me studentët, pasi kandidatët për studentë kanë fituar statusin e studentit, u vihet në dispozicion <i>username</i> dhe fjalëkalim personal për përdorim në hapësirën e dedikuar për studentët në UVMS (Evidenca III.14). Stafi akademik, stafi ndihmësakademik (sekretaritë) dhe studentët menaxhojnë llogarinë e tyre personale nëpërmjet <i>username</i> dhe kodit të sigurisë, të siguruara pranë sekretarisë mësimore. UVMS funksionon shumë mirë dhe arrin të realizojë bashkëpunim e komunikim interaktiv në distancë midis pedagogëve dhe studentëve.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, përmes Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I dhe të II, disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve për çdo program, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna përftohen nga sekretaria mësimore e FSHH, e cila administron: Regjistrin Themeltar të Studentëve; Regjistrin e arritjeve akademike; Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Këto informacione ruhen me shkrim dhe në formë elektronike sipas Statutit të UV-së (Evidenca III.17).			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u konstatua se UV disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve "Bachelor" që nga pranimi i studentit e deri në diplomimin e tij, të dhëna të cilat ruhen nga sekretaria mësimore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja në: Regjistrin Themeltar të Studentëve; Regjistrin e arritjeve akademike; Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave bëhet duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe kërkesat e legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Vetjake.			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit UVMS dhe janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Platforma UVMS mundëson shërbime për: sektorin e IT-së; pedagogët; sekretarinë; studentët; specialistin për shërbimet ndaj studentëve.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UV harton Raportin Vjetor (Evidencat I dhe J), në të cilin vlerësohet, ndër të tjera, edhe veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve të ofruara nga universiteti. Megjithatë, i duhet kushtuar edhe më shumë vëmendje gjurmimit të studentëve pas diplomimit me qëllim sigurimin e të dhënave të sakta dhe të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e cilësisë së punësimit të tyre (Evidenca I.10). Në këtë mënyrë mund të kuptohet më mirë lidhja e programit të studimit me tregun e punës dhe dinamika e këtij të fundit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre	Janë ngritur tashmë këshillat studentorë në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Institucioni ka vënë në dispozicion të Këshillit Studentor të Fakultetit një ambient për të kryer mbledhjet e këshillit dhe kjo u konstatua gjatë vizitës virtuale në institucion. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve në zgjedhjen e përfaqësuesit të tyre në Bordin e Administrimit është konkretizuar në zgjedhjet për anëtarin përfaqësues të studentëve. Gjithashtu, në Statutin e UV-së, neni 22 pika 1, 2, 3, 4 në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





regullatore të vetë IAL-ve.	përbërjen e komisioneve të përhershme parashikohet një student duke garantuar kështu përfshirjen e tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në takimin e realizuar me studentët, ata konfirmuan se institucioni garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik dhe kjo përfshirje është reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate të verifikueshme e të matshme. Vlen të përmendet këtu pjesëmarrja e tyre në mbledhjet e senatit akademik të institucionit, apo edhe në komisionet <i>ad-hoc</i> për çështje të ndryshme.  Mendimet dhe vlerësimet e studentëve për programet e studimit, të vjela përmes pyetësorit të studentëve për vetë programin (Evidenca L), por edhe për shërbimet që marrin në UV (Evidenca III.5), analizohen nga strukturat përkatëse dhe u përcillen për vlerësim njësisive bazë, të cilat bëjnë analizat përkatëse (Evidenca K).			
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, DGJH mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit “Bachelor në gjuhë italiane” dhe parashikon procedura joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. Ndryshimet dhe përmirësimet e këtij programi (Evidenca I.13) që janë bërë kryesisht për shkak të ndryshimeve ligjore (hyrja në fuqi e VKM nr.41, datë 24.01.2018), kanë pasur parasysh ndër të tjera harmonizimin e ngarkesës në disa lëndë, për të cilat janë propozuar ndarje në module. (RVB)  <i>Këshillohet të bëhen përsëri ndryshime në programin e studimit për të pasur një raport më të drejtë mes lëndëve të gjuhësisë dhe lëndëve të tjera që e ndihmojnë studentin të marrë njohuri të tjera të rëndësishme të kulturës së gjuhës së huaj.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nga takimi virtual me autoritetet drejtuese të institucionit dhe studentët u konfirmua se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Raportet e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve (Evidenca K) të përgatitur nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional shërbejnë si bazë për diskutime dhe reflektime mbi përfundimet e dala nga këto raporte për DGJH-në lidhur me lëndët e ofruara në program dhe aspekte që kanë nevojë për përmirësim. Këto përfundime DGJH i reflekton në analizat e veta.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Sipas Rregullores së UV-së (Evidenca C, neni 61), studentët gëzojnë të drejtën të njihen me vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale për të gjitha format e kontrollit të dijeve të përcaktuara në syllabusin e lëndës/modulit përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare. Gjithashtu, e drejta e studentit për t’u njohur me vlerësimin dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit garantohej nga neni 9 i Rregullores së programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane”			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht <b>X</b>



**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Për garantimin e të drejtës për informim të studentëve UV ka ngritur struktura organizative në përputhje me parashikimet ligjore. Informimi bëhet përmes: Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I dhe të II me dy sektorët e saj (Sektorin e Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj studentit dhe Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive). Gjithashtu, informimi i studentëve lidhur me programin e studimit, detyrimet akademike dhe shlyerjen e tyre, aktivitetet e ndryshme, diplomimin, problematikat në lidhje me procesin mësimor etj., realizohet edhe nga sekretaria mësimore. Një rol i rëndësishëm luhet edhe nga koordinatori për marrëdhëniet me studentët, i cili ka rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin dhe orientimin e studentëve (Evidenca II.3).</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet nga Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni-t dhe Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive, i cili shërben si urë lidhëse midis studentit dhe tregut të punës, duke krijuar kontakte dhe marrëdhënie bashkëvepruese me punëdhënësit potencialë, me bizneset, aktorët e tjerë ekonomik lokalë e më gjerë, me qëllim promovimin e studentëve dhe krijimin e mundësive të reja të punësimit për ta. Gjithashtu, Zyra e Shërbimeve (specialistët) ndaj studentit, përgjigjet për jetën studentore, për këshillimin e karrierës dhe veprimtarinë e klubeve, për organizimet e aktiviteteve studentore, për ndjekjen dhe organizimin e çështjeve të karrierës së studentëve në UV. Specialistët e kësaj zyre i asistojnë studentët edhe për njohjen e legjislacionit universitar, për përfitimin e bursave etj. (RVB)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga takimi virtual me specialistë të Sektorit të Këshillimit të Karrierës, Alumni-t dhe Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive u konfirmua se ky sektor realizon herë pas here gurmimin e studentëve, të cilin e raporton në raportin vjetor të universitetit (Evidenca J). Megjithatë, ekziston mundësia për një angazhim më të madh në këtë drejtim.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>





standardit				X
------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti i Vlorës ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura që i shërbejnë sigurimit të brendshëm të cilësisë. Mund të përmenden këtu plani strategjik i institucionit 2018-2024 (Evidenca B), politikat dhe masat operative të të cilit synojnë përmbushjen e objektivave të UV-së. Me Vendimin e Senatit nr. 8, datë 14.02.2018 (Evidenca III.1) është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, pjesë e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve (DSBCP).</p> <p>Në takimin me autoritetet drejtuese të FSHH u informuam që NJSBVCII është duke punuar për hartimin e një draft rregulloreje për sigurimin e cilësisë, e cila ende nuk ka përfunduar dhe nuk është përcjellë për miratim në senat.</p> <p>Ndërkohë, në Statutin e Universitetit (neni 21, 22) parashikohet ngritja e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Megjithatë, nga takimet e zhvilluara me autoritetet drejtuese të institucionit, u konfirmua që këto komisione nuk kanë funksionuar deri më sot.</p> <p><i>Këshillohet ngritja e Komisioneve të Përhershme, siç parashikohet nga Statuti i Universitetit dhe Ligji për arsimin e lartë 80/2015, si edhe hartimi i Rregullores për sigurimin e cilësisë në UV.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Në funksion të sigurimit të cilësisë janë marrë një sërë vendimesh nga ana e Senatit të UV-së.</p> <p>Vendimi i Senatit nr. 21, datë 08.05.2018 “Për procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi në Universitetin e Vlorës” ku përshkruhet procedura e përmirësimit të programeve të studimit duke filluar që prej realizimit të analizës së rezultateve të pyetësorëve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim (Evidenca III.3).</p> <p>Vendimi i Senatit nr. 51, datë 20.09.2019 “Për miratimin e Pyetësorit për Studentët për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej Stafit Administrativ dhe Ndihmës/akademik në UV” (Evidenca III.5). Ky instrument ka për qëllim vlerësimin dhe</p>



	<p>monitorimin e cilësisë së shërbimeve që studentët marrin gjatë jetës studentore në UV prej strukturave mbështetëse për programet e studimit.</p> <p>Vendimi i Senatit nr. 52, datë 20.04.2017 “Për miratimin e formularit për vlerësimin e performancës së personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme” (Evidenca I.20 - modeli i formularit).</p> <p>Pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet organizimit të tryezave të rumbullakëta (RVB).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, i është nënshtruar vlerësimit të jashtëm institucional. Procesi i akreditimit të parë institucional të UV-së përfundoi me vlerësimin përfundimtar pozitiv dhe akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh akademike deri në datën 30.09.2020 (Evidenca VI.1). Pas përfundimit të procesit të akreditimit, institucioni hartoi një plan veprimi me qëllim pëmbushjen e rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit. Gjithashtu, në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBVCII në fund të çdo semestri para sezonit të provimeve, organizohet pyetësi studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi (Evidenca L).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e universitetit (neni 86) parashikohen procedurat që duhet të ndjekë institucioni me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sërë instrumentesh. Siç u tha edhe më lart, në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBVCII në fund të çdo semestri para sezonit të provimeve, organizohet pyetësi studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi (Evidenca L). Me Vendim të Senatit Akademik është miratuar procedura e përmirësimit të programeve të studimit duke filluar që nga analiza e rezultateve të pyetësorëve deri në planin e masave që propozohet për përmirësimin e programit studimor (Evidenca III.4).</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

## Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të syuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Si strukturë e posaçme për monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimorë në nivel institucioni është ngritur Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, me një sektor të veçantë: <i>Spektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentit</i>. Përgjegjësi e këtij të fundit janë ndjekja dhe zbatimi i bazës ligjore në fuqi që nga hapja, riorganizimi apo mbyllja e programeve të studimit. Gjithashtu, funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit</p>



	<p>Institucional (Evidenca III.1). Siç është theksuar edhe më lart, në Statutin e Universitetit parashikohet ngritja e Komsioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Megjithatë, siç lexohet edhe në RVB dhe siç u konfirmua nga takimet e zhvilluara me autoritetet drejtuese të institucionit, këto komisione nuk kanë funksionuar deri më sot dhe në mungesë të tyre është zv.dekani për anën akademike, i cili në bashkëpunim me dekanin e fakultetit mbështesin dhe orienojnë politikat për zhvillimin e monitorimin e programeve të studimit që ofrohen nga fakulteti përkatës.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara; për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Në proceset formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë përfshihen raportet vjetore të veprimtarisë institucionale (Evidenca J). Gjithashtu, në nivel institucioni funksionon Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, e cila vlerëson propozimet mbi ndryshimet e mundshme të programit mësimor dhe i përcjell më tej në Senatit Akademik për miratim. Ndërkohë, duhet theksuar edhe plotësimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve (Evidenca L).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>NJSBVCI ka zhvilluar anketimin e studentëve me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Metodologjia e studimit ka qenë sasiore dhe instrumenti i përdorur është pyetësori i miratuar me Vendim të Senatit Akademik (Evidenca III.3). Gjithashtu, UV realizon çdo vit vlerësimin e performancës së personelit akademik (Evidenca I.20) dhe ndihmësakademik e administrative (Evidenca I.21) në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe fakultetet.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>NJSBVCI përveç raportit të analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlojë, përpilon dhe projekt-propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë (Evidenca K). Raporti i rezultateve të pyetësorëve, si edhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBVCI-së iu përcillen njësisë kryesore, të cilat realizojnë më tej një konsultim të gjerë në çdo njësi bazë me stafin akademik. Njësitë bazë diskutojnë rezultatet e pyetësorëve dhe japin propozimet përkatëse (Evidenca III.2).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e analizës (Evidenca K) përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit që, siç u theksua më lart, pas një diskutimi në njësitë kryesore/bazë dhe marrjes së propozimeve përkatëse, i përcillet për miratim Senatit Akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



**tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Çdo fundvit akademik Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë përpilon Raportin Vjetor sipas Udhëzimit Nr.5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” ku pasqyrohet veprimtaria institucionale përmes një analize të procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij. Gjithashtu, për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë, NJSBVCII harton raportin e analizës së pyetësorëve, i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikën më të mira. Duhet theksuar se Raporti i Vetëvlerësimit i përpiluar prej Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në nivel Institucioni, në kuadër të akreditimit të bërë në vitin 2017, ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për NJSBVCII dhe strukturat e institucionit të angazhuara në përmirësimin e cilësisë. (RVB).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren (neni 86) e universitetit parashikohen instrumentet e kërkimit dhe procedurat që duhet të ndjekë institucioni me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sërë instrumentesh. Një nga format e aplikuara nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, është edhe studimi i tregut të punës (Evidenca I.10). Gjithashtu, në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBVCII në fund të çdo semestri para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi (Evidenca L).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinsticionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren (neni 86) e universitetit parashikohen instrumentet e kërkimit dhe procedurat që duhet të ndjekë institucioni me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sërë instrumentesh.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me përgjegjësen e departamentit u konfirmua se, ashtu siç theksohet edhe në RVB, në fillim të vitit akademik përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me stafin akademik të departamentit vlerëson përmbytjen e kurrikulave, syllabuseve etj. për përmirësim të mëtejshëm të tyre duke mbajtur në konsideratë edhe rekomandimet e vitit të mëparshëm akademik. Gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme, përgjegjësi i departamentit realizon vëzhgime në auditor për mbarëvajtjen e mësimit duke përdorur kështu instrumente të drejtpërdrejta për vlerësimin e mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista</p>	<p>Sa u përket instrumenteve të tërthorta vlen të përmendet se, në mënyrë periodike, nëpërmjet NJSBVCII, në fund të çdo semestri para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi (Evidenca L). Analiza e këtij pyetësori bën të mundur identifikimin e pikave të dobëta ku duhet ndërhyrë për përmirësimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit (Evidenca III.3).</p> <p>Gjithashtu statistikat mbi punësimin e studentëve dhe llojin e punës, karrierën e tyre, informacion që vjen nga Sektori i Këshillimit të Studentëve, ALUMNI dhe Aktiviteteve Kulturorë – Sportive, janë një tregues i tërthortë mbi cilësinë e programeve të studimit të ofruar prej</p>




<p>të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>këtij universiteti.</p> <p>Një tjetër instrument është edhe takimi me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe Alumni-t, për të bashkëndarë eksperiencat me synim përmirësimin e kurrikulave dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës, si në rastin e ëorkshop-it “Studentët dhe tregu i punës” (Evidenca I.12), i organizuar nga NJSBVCI në bashkëpunim me Drejtorinë e Edukimit, Drejtorinë e Komunikimit dhe të Burimeve Njerëzore dhe Fakulteteve përkatëse.</p> <p><i>Pavarësisht këtyre intrumenteve të përdorur, mund të thuhet se është e nevojshme të aplikohet një gamë më e gjerë metodash në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, përfshirë zbatimin më të gjerë të metodave e instrumenteve të tërthorta të vlerësimit. Gjithashtu, për vjeljen e informacionit prej ALUMNI-t duhet të punohet edhe më shumë. Mungon një database e plotë me të dhënat gjurmuese të ish-studentëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në Statutin, Rregulloren dhe në Planin Strategjik 2018-2024 të UV-së parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Megjithatë, theksojmë përsëri mungesën e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë dhe të Rregullores për sigurimin e cilësisë në UV.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Siç u tha më lart, në dokumentet bazë të institucionit, parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>Megjithatë, mund të bëhet edhe më shumë për garantimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe një ndarje më e qartë e detyrave për secilin aktor të procesit të vlerësimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e</p>	<p>Sipas dokumenteve të përmendura në RVB (Evidencat A, B dhe C), parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Theksojmë përsëri, këtu, mungesën e Komisionit të Përhershëm të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Sigurimit të Cilësisë, në përbërje të të cilit do të kishte edhe përfaqësues nga radhët e studentëve, ndonëse vjelja e mendimit të studentëve lidhur me cilësinë e programit të studimit sigurohet përmes organizimit të pyetësorit të realizuar nga NJSBVCII (Evidenca L). Pozitive është edhe pjesëmarrja e studentëve në grupe të ndryshme të ngritura me qëllim përpilimin dhe rishikimin e instrumenteve të vlerësimit të brendshëm (Aneksi 1, tabela 24).			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga takimet e realizuara me studentët, personelin akademik, njësitë dhe autoritetet drejtuese të institucionit, nuk konstatuam mungesë të respektimit të integritetit akademik, apo ekzistencën e diskriminimit apo pabarazisë kundrejt personelit dhe studentëve. Gjithashtu, respektimi i integritetit akademik dhe mungesës së diskriminimit kundrejt personelit dhe studentëve garantohet edhe në dokumente të tilla si: Statuti, Rregullorja e UV-së apo Rregullorja e programit të studimit (Evidenca I.4). Në kuadrin e leksioneve të mbajtura nga lektorë të ftuar (Evidenca III.9), të organizuara nga Drejtuesi i Njësisë bazë apo Dekanati, ndonëse nuk ka patur reagime nga personeli i përfshirë, ky proces nga një pjesë e stafit perceptohet si mungesë respekti ndaj integritetit akademik dhe i paragjykuar nga aktorët e brendshëm të përfshirë në proceset ciklike të vlerësimit. <i>Këshillohet më shumë transparencë në organizimin e eventeve të tilla akademike në respekt të integritetit akademik të të gjithë kolegëve.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në funksion të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni pranon përfshirjen e aktorëve të ndryshëm që kanë lidhje me programin e studimit apo që mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Mund të përmendet këtu ëorkshop-in me temë “ <i>Studentët dhe tregu i punës</i> ” (Evidenca I.12), aktiviteti i cili gjendet i publikuar në faqen e internetit të universitetit. Përveç drejtuesve të institucionit, personelit akademik dhe studentëve, morën pjesë përfaqësues dhe drejtues institucionesh publike dhe private, të cilët propozuan një paketë rekomandimesh për përmirësimin e programeve të studimit dhe marrëdhëniet bashkëpunuese institucionale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit gjenden të publikuara në faqen e internetit të universitetit ( <a href="https://univlora.edu.al/">https://univlora.edu.al/</a> ), lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe të gjithë të interesuarit dhe përcillen me shkresa zyrtare tek të gjitha njësitë kryesore, njësitë bazë duke krijuar kështu një universitet të hapur dhe transparent me të gjithë

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Është hartuar Raporti i Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për çdo lëndë të çdo programi studimi (Evidenca III.3). Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Raporti publikohet në nivel njësie kryesore dhe përmban raportet përkatëse të çdo departamenti. (RVB)			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Siç është theksuar edhe më lart, NJSBVCII përveç raportit të analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë (Evidenca III.3), përpilon dhe projekt-propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë duke i përcjellë më tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. Raporti i rezultateve të pyetësorëve, si dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBVCII-së (Evidenca K) iu përcillen njësite kryesore, të cilat realizojnë më tej një konsultim të gjerë në çdo departament me stafin akademik. Njësitë bazë diskutojnë rezultatet e analizës duke bërë edhe propozimet përkatëse.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në takimin me autoritetet drejtuese të fakultetit u konfirmua se përmirësimi i vazhdueshëm i instrumenteve të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, është një prej objektivave të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Në planin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit është vendosur, me urdhrin e Rektorit Nr. 123 datë 19.12.2019, ngritja e grupit të punës, në nivel institucional, me qëllim përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi (Evidenca VI.3).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në takimet e realizuara, na u konfirmua se Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre (nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, sondazheve, pjesëmarrjes aktive në grupe pune etj.) në procesin e sigurimit dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Këtu përfshihen takime me studentët në auditorë, publikimet në rrjetet promovuese online të universitetit, publikimet e njoftimeve në UVMS etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	



## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në Gjuhë italiane” të Universitetit “Ismail Qemali”

### **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Ngritja e Grupeve mësimore me karakter kërkimor, si struktura që bashkërendojnë mësimdhënien dhe kërkimin në grup-disiplinat përkatëse në program: gjuhësi, letërsi dhe kulturë, përkthim dhe gjuhë e huaj për qëllime të posaçme dhe metodikë. (Standardi I.5, kriteri 1/ Standardi I.4, kriteri 1)
2. Mobilitetet si të stafit ashtu edhe të studentëve ndër vite si për mësimdhënie ashtu edhe për trajnime të ndryshme e kanë pozicionuar DGJH në pozicion pararojë në këtë aspekt. (Standardi 1.5 kriteri 2)
3. Marrëveshjet ndër-institucionale brenda dhe jashtë vendit me partnerë homologë brenda dhe jashtë vendit janë gjithashtu mjaft domethënëse në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të punës kërkimore shkencore dhe cilësisë. (Standardi I.5 kriteri 2)
4. Projektet kombëtare dhe ndërkombëtare e ndërajonale të vazhdueshme ndër vite dhe gjithpërfshirëse janë një tregues mjaft i mirë i punës së kësaj IAL dhe e DGJH. (Standardi 1.5 kriteri 2)
5. Prania e Lektorit italian, folës i gjuhës amëtare, konsiderohet praktikë e mirë në mbështetje të objektivave formuese të programit. (Standardi II.5, kriteri 1)
6. Hapësirat e aktiviteteve sportive dhe aktiviteteve të tjera (2000 m<sup>2</sup>) janë tregues i vëmendjes së treguar ndaj studentit të kësaj IAL edhe në lidhje me aspekte të tjera jashtë kontekstit të mësimdhënies. (Standardi III.3 kriteri 1)
7. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është i kualifikuar dhe angazhohet në mësimdhënie sipas fushave të specializimit. (Standardi III.2 / standardi III. 3 kriteri 4)
8. Biblioteka e pasur dhe Këndi i Leximit në shërbim të studentëve. (Standardi IV.4, kriteri I / Standardi III.3 kriteri 5)
9. Libraria online “ULIBRARY” (standarti III.3 kriteri 6)
10. Koordinatorin për marrëdhëniet me studentët, me një rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin dhe orientimin e studentëve (Standardi V.6, kriteri 2)
11. Sipërfaqja e ambienteve në dispozicion të studentëve (2.8 m<sup>2</sup>/student ) dhe në dispozicion të stafit (10.3 m<sup>2</sup>/person) më se të mjaftueshme për zhvillimin sa më mirë të veprimtarive mësimore (Standardi IV.3, kriteri 1).
12. Përfshirja e studentëve në aktivitete kërkimore shkencore dhe pjesëmarrja e tyre në konferenca është një praktikë mjaft e mirë.
13. Mbështetja financiare ndaj stafit dhe studentët në lidhje me punën kërkimore – shkencore, publikimet etj. (Standardi IV.II kriteri 2 / standardi III.7 kriteri 9).






### **Pika të dobëta:**

1. DGJH nuk disponon një strukturë të qëndrueshme të ruajtjes së lidhjeve me ish-studentët si një burim të dhënash për punësimet aktuale të këtij programi ose si një mundësi për të vjelë prej tyre njohuri rreth ndryshimeve në kurrikul në përputhje me nevojat aktuale të tregut. (Standardi I.1, kriteri 1)
2. Mungesa e organizimit të trajnimeve për stafin akademik me qëllim që pedagogët të jenë gjithmonë të përditësuar me metodat inovative të mësimdhënies edhe në funksion të sigurimit të cilësisë në mësimdhënien e programit të studimit. (Standardi IV.2, kriteri 3)
3. Laboratori, i cili përdoret për zhvillimin e lëndës së *Përkthimit* nuk është i pajisur me software specifik për përkthimin. (Standardi IV.3, kriteri 4)
4. Mungon një laborator për zhvillimin e lëndës së *Interpretimit*. (Standardi IV.3, kriteri 4)
5. Mungesa e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore dhe i Rregullores për sigurimin e cilësisë në UV. (Standardi VI.1, kriteri 1)
6. Nuk aplikohet një gamë e gjerë dhe e larmishme metodash në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit. (Standardi VI.2, kriteri 3)
7. Mungon një database e plotë me të dhënat gjurmuese të ish-studentëve. (Standardi VI.3, kriteri 4)

### **Rekomandime:**

1. DGJH duhet të rrisë gamën e ruajtjes së lidhjeve me Alumni dhe të gjenerojë forma të tjera të përfshirjes së tyre konkrete në aktivitetin e tij akademik dhe kërkimor përveç atyre ekzistues.
2. Laboratori rekomandohet të pajiset me software specifik për përkthimin pasi do të kishte efekt pozitiv në realizimin e programit të studimit dhe përforcimin/zbatimin e njohurive teorike në fushën e përkthimit.
3. Të shikohet mundësia e blerjes së një laborator për lëndën e *Interpretimit* me qëllim zhvillimin e kësaj lënde sipas standardeve të kërkuara akademike.
4. Këshillohet organizimi i trajnimeve për stafin akademik me qëllim që pedagogët të jenë gjithmonë të përditësuar me metodat inovative të mësimdhënies.
5. Rekomandohet ngritja e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, siç parashikohet nga Statuti i Universitetit dhe Ligji për arsimin e lartë 80/2015, si edhe hartimi i Rregullores për sigurimin e cilësisë në UV.
6. Sugjerohet një analizim më i mirë i tregut të punës dhe gjurmimit të mëtejshëm të punësimit të studentëve pavarësisht vështirësive të hasura e të paraqitura. (standardi 1.3 kriteri 2)
7. Rekomandohet një harmonizim dhe një përafrim më të plotë të programit të studimit me ato të programeve të departamenteve simotra të IAL (standardi II.2 kriteri 4)





8. Të bëhen ndryshime në programin e studimit për të pasur një raport më të drejtë mes lëndëve të gjuhësisë dhe lëndëve që e ndihmojnë studentin të marrë njohuri të tjera të rëndësishme të kulturës së gjuhës së huaj. Rekomandohet:
- Futjen si lëndë e detyrueshme të një moduli “Histori e Italisë” dhe jo si opsion me zgjedhje;
  - Rishikimin e përmbledhjeve të lëndëve të paraqitura në një format të ngjashëm;
  - Rishikimin e lëndëve me shumë kredite;
  - Rishikimin e raportit teori/praktikë të disa lëndëve;
  - Zëvendësimin e disa lëndëve shumë teorike gjuhësore me lëndë me karakter më praktik që zhvillojnë shumë më tepër aftësitë bazë;
  - kalimin e disa lëndëve me profil specifik në ciklin e dytë të studimeve;
  - rishikimin e emërimit të disa lëndëve.

Për sa më lart në pikën 8 shiko sugjerimet tek (standardi II.4 kriteri 4)

9. Rekomandohet rishikimin i formulimit të diplomës (standardi III. 3 kriteri 10)

10. Rekomandohet ulje e mesatares për hartim teme diplome (standardi III. 3 kriteri 10)

11. Rekomandohet një raportim periodik mbi testimin e përdorimit të metodave inovatore. (Standardi III.5)

12. Rekomandohet që DGJH të mundësojë evidentimin e faktit sesa e kanë përdorur studentët por edhe stafi shërbimin e bibliotekës online. (Standardi III.2 kriteri 5)

***Shënim: Për informacione më të detajuara në lidhje me rekomandimet e dhëna ju lutemi t'i drejtoheni evidentimeve dhe sugjerimeve të standardeve dhe kritereve përkatëse.***




## **Conclusions of the study program evaluation of the first cycle Bachelor in "Italian Language" at the University "Ismail Qemali", Vlora**

### **Strengths and affirmations:**

1. Establishment of teaching groups with a research character, as structures that coordinate teaching and research in the respective group-disciplines in the program: linguistics, literature and culture, translation and foreign language for special and methodological purposes. (Standard I.5, criterion 1 / Standard I.4, criterion 1)
2. The mobility of both staff and students over the years for both teaching and training has positioned DFL in a leading position in this regard. (Standard 1.5 criteria 2)
3. Inter-institutional agreements at home and abroad with counterpart partners at home and abroad are also very significant in terms of further development of scientific research and quality. (Standard I.5 criteria 2)
4. Ongoing national and international and interregional projects over the years and comprehensive are a very good indicator of the work of this HEI and DFL. (Standard 1.5 criteria 2)
5. The presence of the Italian Lecturer, a native speaker, is considered a good practice in support of the training objectives of the program. (Standard II.5, criteria 1)
6. Spaces of sports activities and other activities (2000 m<sup>2</sup>) are an indicator of the attention shown to the student of this HEI also in relation to other aspects outside the teaching context. (Standard III.3 criteria 1)
7. The academic staff engaged in the study program is qualified and engaged in teaching according to the fields of specialization. (Standard III.2 / standard III. 3 criteria 4)
8. Rich Library and Reading Corner at the service of students. (Standard IV.4, criterion I / Standard III.3 criterion 5)
9. Online library "ULIBRARY" (standard III.3 criteria 6)
10. Coordinator for student relations, with an important role in informing, advising and orienting students (Standard V.6, criterion 2)
11. Area of facilities available to students (2.8 m<sup>2</sup> / student) and available to staff (10.3 m<sup>2</sup> / person) more than sufficient for the best possible development of learning activities (Standard IV.3, criterion 1).
12. Involving students in scientific research activities and their participation in conferences is a very good practice.
13. Financial support to staff and students in relation to research - scientific work, publications, etc. (Standard IV.II criteria 2 / standard III.7 criteria 9).

### **Weaknesses:**

1. DFL does not have a stable structure to maintain links with alumni as a source of data on current employment of this program or as an opportunity to gain knowledge about curriculum changes in line with current market needs. (Standard I.1, criterion 1)
2. Lack of organization of trainings for the academic staff in order for the pedagogues to be always updated with the innovative teaching methods also in order to ensure the quality of the teaching of the study program. (Standard IV.2, criteria 3)
3. The laboratory, which is used for the development of the translation subject is not equipped with specific translation software. (Standard IV.3. Criteria 4)
4. There is no laboratory for the development of the subject of Interpretation. (Standard IV.3, criterion 4)





5. Lack of Permanent Quality Assurance Commissions at the level of the main institution and unit and the Regulation on quality assurance in UV. (Standards VI.1, criteria 1)
6. A wide and diverse range of methods is not applied in the framework of evaluation of the realization, progress and quality of the study program. (Standard VI.2, criterion 3)
7. A complete database with tracking data of former students is missing. (Standards VI.3, criteria

**Recommendations:**

1. DFL should increase the range of maintaining ties with Alumni and generate other forms of their concrete involvement in its academic and research activity in addition to the existing ones.
2. The laboratory is recommended to be equipped with specific software for translation as it would have a positive effect on the realization of the study program and the reinforcement / application of theoretical knowledge in the field of translation.
3. To consider the possibility of purchasing a laboratory for the subject of Interpretation in order to develop this subject according to the required academic standards.
4. It is advisable to organize trainings for the academic staff so that the lecturers are always updated with innovative teaching methods.
5. It is recommended to establish Permanent Quality Assurance Commissions at the level of the main institution and unit, as provided by the Statute of the University and the Law on Higher Education 80/2015, as well as the drafting of the Regulation on quality assurance in UV.
6. A better analysis of the labor market and further tracing of student employment is suggested despite the difficulties encountered and presented.
7. It is recommended a harmonization and a more complete approximation of the study program with those of the programs of the similar departments of the HEI (standard II.2 criteria 4)
8. Make changes in the study program to have a fairer relationship between linguistics subjects and subjects that help the student acquire other important knowledge of foreign language culture.


Recommended:

- Introduction as a compulsory subject of a module "History of Italy" not as optional;
- Review of subject summaries presented in a similar format;
- Review of multi-credit subjects;
- Review of the theory / practice report of some subjects;
- Replacing some very theoretical language courses with more practical ones that develop much more basic skills;
- passing some courses with a specific profile in the second cycle of studies;
- reviewing the names of some subject.

For the above in point 8 see the suggestions in (standard II.4 criteria 4)

9. It is recommended to review the diploma formulation (standard III. 3 criteria 10)
10. It is recommended to reduce the average for drafting a diploma thesis (standard III. 3 criteria 10)
11. Periodic reporting on testing the use of innovative methods is recommended. (Standards III.5)
12. It is recommended that DFL enable the evidence of the fact how much the students but also the staff have used the online library service. (Standard III.2 criteria 5)

**Note: For more detailed information regarding the recommendations given, please refer to the evidence and suggestions of the relevant standards and criteria.**





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X